



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim Nr. 37
Tetor 2020



REVOLUCIONI I PAGESAVE



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

SIGURIA KIBERNETIKE

Tetor

#mbro veten #mbro organizatën

ANËTARËT E AAB-së



PËRMBAJTJA

Bankieri

Nr. 37, Tetor 2020

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave



REDAKSIA:

Elvin Meka
Kryeredaktor
 Eftali Peçi
Koordinatorë
 Dorina Zarka
Fotografe
Design & Layout: FCB Afirma

Shtypi nga: Gent-grafik

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. Bankieri i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,
 SKY TOWER, 9/3, Tiranë
 Tel: +355 4 2280371/2
 Fax: +355 4 2280 359
 www.aab.al

Editorial

Revolucioni i pagesave në Shqipëri - "shkatërrimi krijues" për një model të ri biznesi bankar
 Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA 5

Tema e Ditës

Ligji i ri për shërbimin e pagesave - Një zhvillim i mirëpritur dhe i rëndësishëm
 Prof. Dr. Luljeta MINXHOZI 6

Ligji i ri për pagesat - sfida dhe mundësi për sektorin bankar shqiptar
 Kerem PAMUK
 Ardian HASA
 Gentian CAPO 9

Zhvillimet e reja në fushën e pagesave - Një treg i hapur për konkurrencë dhe shërbim cilësor
 Geis ÇEKU, MSc.
 Jonida KËLLEZI
 Perlat SULAJ 12

Shtatë sisteme së bashku, për një sistem pagesash efikas dhe funksional
 Vladimir VASIĆ 17

Speciale

Pandemia, borxhi publik dhe ekonomia
 Anila DENAJ, Ministër 19

Intervista

UNION BANK - të përkushtuar për automatizimin dhe modernizimin e shërbimeve bankare
 Flutura VEIPI 24

Sistemi Bankar

Bankat - një realitet i domosdoshëm për ekonominë dhe shoqërinë
 Dr. Spiro BRUMBULLI 26

Përtej moratoriumit të kësteve të huave - Çështje për t'u adresuar dhe menaxhuar nga sektori bankar
 Admira LLAZARI 28

Forumi i Ekspertëve

Legjislacioni i ri për tregun e kapitaleve - një investim i rëndësishëm për zhvillimin dhe thellimin e sistemit financiar shqiptar
 Niko KOTONIKA 31

Drejt mentalitetit të përparësisë digjitale
 Vladimir DJORDJEVIC 33

Renminbi digjital - një pashmangshmëri teknike
 Dr. Genti BEQIRI 35

Pergjegjësia Sociale e Korporatës

Të reja nga sektori bankar 42

AAB: Aktivitete - Trajnime

43

BORDI EDITORIAL:

Silvio PEDRAZZI
 Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Intesa Sanpaolo Bank Albania

Georgios PAPANASTASIOU
 Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Alpha Bank Albania

Adrian CIVICI
 Dekan Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Maltin KORKUTI
 Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Credins Bank

Dritan MUSTAFA
 Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Bank

Eleonora OLLI
 Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)

Andi BALLTA
 Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, American Bank of Investments

Ervin METE
 Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Spiro BRUMBULLI
 Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave

Karta e Kreditit Mastercard

MIRËPRIT KARTËN E RE TË KREDITIT MASTERCARD!



ZERO KOMISION
PËR VITIN E PARË

Pagesa
pa kontakt

Përdorim
në internet

Dizajn
unik

Një kartë. Një pafundësi momentesh.



ALPHA BANK



mastercard.

Revolucioni i pagesave në Shqipëri

"Shkatërrimi krijues" për një model të ri biznesi bankar



Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹

Kryeredaktor

Me hyrjen në fuqi të Direktivës së Rishikuar të Shërbimit të Pagesave (PSD2), në janar 2018, mund të thuhet se Revolucioni i Katërt Industrial po jep frytet e tij të plota, në fushën e pagesave. Kjo është kaq e vërtetë sa që, brenda një kohe shumë të shkurtër, po vërehen ndryshime rrënjësore në Evropë, për sa i përket sistemeve të pagesave.

Ky transformim revolucionar, fatmirësisht ka trokitur tashmë edhe në dyert e sistemit financiar shqiptar, pasi vetëm pak muaj më parë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin e ri "Për shërbimet e pagesave". Në tërësinë e tij, ky ligj bën një përfarim domethënës me direktivën e rishikuar për shërbimet e pagesave (ose PSD2) të Bashkimit Evropian. Këtu vlen të

theksohet se, një lëvizje dhe zhvillim kaq i fortë strukturor në nivel evropian, fillon dhe bëhet pjesë e sistemit ekonomik për herë të parë kaq shpejt në Shqipëri. Sigurisht që një zhvillim i tillë nuk kishte se si të mos ndodhte brenda sistemit dhe sektorit bankar shqiptar, i cili jo vetëm mbetet veprimtaria më serioze, më e mirë-organizuar dhe më e gatshme për të përballuar dhe financuar ndryshimin, por dhe më afër strukturave ekonomike të BE-së.

Përtej fakteve të mirënjohura që, ligji i ri do të mundësojë një mbrojtje më të mirë të konsumatorëve, futje të lojtarëve të rinj në treg, shtim të konkurrencës dhe shërbime pagese më të lira, ai nuk do të mjaftohet vetëm duke i hapur rrugë një transformimi rrënjësor të shërbimit të pagesave. Tashmë e në vijim, ato nuk do të jenë më kurrë si deri më sot, në formë dhe përmbajtje, por mbi të gjitha, ky ligj do të "shkundë" tërësisht modelin e veprimtarisë bankare në vend. Legjislati (ligji plus të gjitha aktet e tjera nënligjore në vijim) do të lejojë brenda sistemit financiar shqiptar zbatimin e "*shkatërrimit krijues*", të ikonizuar nga Joseph Schumpeter, i cili më shumë se tetë dekada më parë argumentonte se, novacioni ishte forca shtytëse themelore e zhvillimit historik të kapitalizmit, qoftë ky si *proces, ose si produkt*².

Në këtë kuadër, bankat si insti-

tucione të mëdha dhe më novatore në ekonominë shqiptare, i kanë të gjitha mundësitë për ta kthyer në përparësinë e tyre mundësinë e fushës së hapur për konkurrencë ndër sektoriale, jo vetëm midis bankave, por edhe midis bankave dhe institucioneve jo-banka, që krijon ky ligj. Por, këtu duhet kuptuar se, tashmë ato nuk janë thjesht përballë një produkti të ri, për të cilin mjafton thjesht një përshtatje, apo trupëzim në modelin aktual të biznesit; tashmë bëhet fjalë për një *model të ri biznesi*, ku një nga shtyllat kryesore janë *shërbimi i pagesave*!

Realiteti i ri në të cilin bankat do të duhet të operojnë dhe të jenë jo vetëm konkurrese, por dhe novatore, nënkupton që ato duhet domosdoshmërisht të shmangin efektin "KODAK"³, ku institucion-alizimi novator i shërbimit të pagesave, i realizuar nëntë shekuj më parë nga Banka e Venecias dhe investimet e derisotme në shërbimin e pagesave, nuk duhet të konsiderohen si të mjaftueshme për të vijuar biznesin si zakonisht. Ky realitet thërret për një punë dhe përpjekje më të personalizuar me klientin dhe për një qasje krejt të re, në drejtim të tërheqjes së shumë klientëve të rinj. Sfidat këtu është tani për të krijuar "nevoja" të reja e për më tepër, për të krijuar më shumë vlerë të shtuar për klientin!

¹ Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti European i Tiranës, UET.

² Joseph Schumpeter: "Business Cycles: A theoretical, Historical, and Statistical Analysis of the Capitalist Process, Volume I", 1939.

³ Kodak krijoi kamerën digjitale, investoi në këtë teknologji dhe madje e kuptoi që fotot mund të ndaheshin dhe shpërndaheshin online. Ata dështuan në të kuptuarin e faktit se shpërndarja e fotove online ishte biznesi i ri dhe jo thjesht një mënyrë për të zgjeruar biznesin e stampimit të fotove (Scott D. Anthony: "Kodak's Downfall Wasn't About Technology", HBR, 2016).

Ligji i ri për shërbimin e pagesave

Një zhvillim i mirëpritur dhe i rëndësishëm

Risitë e ligjit "Për shërbimet e pagesave" mund të ndikojnë në sistemin financiar dhe atë ekonomik nëpërmjet tri efekteve kryesore të tij: - nxitja e konkurrencës dhe krijimi i shërbimeve financiare novatore, - mbrojtja më e mirë të konsumatorit; dhe - zgjerimi i përfaqësimit të institucioneve ofruese të shërbimeve të pagesave, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.



Prof. Dr. Luljeta MINXHOZI¹

Zëvendësguvernator i Parë
BANKA E SHQIPËRISË

Përfshirja financiare e popullsisë dhe reduktimi i parasë fizike në ekonomi, është kthyer në një prioritet të rëndësishëm për Bankën e Shqipërisë (BSH) dhe Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave, për arritjen e objektivit të shmangies së informalitetit dhe rritjes së transparencës në ekonomi. Në këtë kuadër, që prej vitit 2018 janë ndërmarrë një sërë masash të rëndësishme me qëllim modernizimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël.

Miratimi së fundi i ligjit 55/2020: "Për shërbimet e pagesave" përbën një prej masave të ndërmarra dhe njëkohësisht një arritje shumë të rëndësishme në këtë drejtim. Ky ligj përfshin në kuadrin tonë ligjor të fushës financiare një direktivë

të rëndësishme të Bashkimit Evropian, atë të PSD2 (Direktiva e Shërbimeve të Pagesave 2). Në rrafshin ndërkombëtar, kjo Direktivë konsiderohet si një ligj me objektiv jo vetëm rregullues të sistemit të pagesave, por edhe një ligj i cili nëpërmjet inovacionit nxit zgjerimin e njëkohshëm të pagesave elektronike dhe



Bankat, institucionet e pagesave dhe ato të parasë elektronike, duhet të jenë të kujdesshme në vendimmarrjen e tyre, duke përfutur nga eksperiencia evropiane me qëllim maksimizimin e efekteve të ligjit, por edhe duke u kujdesur që investimet e kryera në institucionet e reja të pagesave të jenë në përputhje me standardet e kërkuara.



tregtisë elektronike. Ligji i ri "Për shërbimet e pagesave" vlerësohet të kontribuojë në nxitjen e përfshirjes financiare të popullsisë, duke lejuar krijimin e shërbimeve të reja financiare, lehtësisht të përdorshme nga publiku i gjerë dhe me kosto më të ulëta.

Dëshiroj të theksoj se risitë e

ligjit "Për shërbimet e pagesave" mund të ndikojnë në sistemin financiar dhe atë ekonomik nëpërmjet tri efekteve kryesore të tij: - nxitja e konkurrencës dhe krijimi i shërbimeve financiare novatore, - mbrojtja më e mirë e konsumatorit; dhe - zgjerimi i përfaqësimit të institucioneve ofruese të shërbimeve të pagesave, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nxitja e Konkurrencës nëpërmjet inovacionit

Ligji i ri forcon bazën ligjore mbikëqyrëse të BSH-së për shërbimet e pagesave, duke siguruar paanshmëri dhe proporcionalitet në licencimin dhe rregullimin e ofruesve të shërbimit të pagesave. Kjo do të thotë se do të rritet konkurrenca midis institucioneve të Shërbimeve të Pagesave, nëpërmjet:

- Balancimit të hapësirave për ofrimin e shërbimeve të pagesave midis bankave dhe institucioneve financiare jo-banka, duke i lejuar këto të fundit të hapin llogari pagese dhe emetojnë instrumente elektronike të pagesave.
- Krijimit të kushteve për nxitjen e inovacionit në fushën e shërbimit të pagesave me vlerë të vogël, duke krijuar mundësi për uljen e kostove të këtyre shërbimeve dhe rritjen e numrit të përdoruesve të tyre.

¹ Mendimet e shprehura në artikull janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

- Krijimin e modeleve të reja të biznesit, me konceptin open banking dhe home banking, që do të lehtësojnë përdorimin e inovacionit në shërbimin e pagesave për palët e treta, siç mund të jenë: shërbimet e inicimit të pagesave dhe institucionet për shërbimin e informimit mbi llogarinë. Këto risi detyrojnë bankat të ndajnë informacion mbi llogarinë e klientit me institucionet e tjera të shërbimit të pagesave e të licencuara nga BSH-ja.
- Hapësira lehtësuese për operimin e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël nga bankat, institucionet e pagesave dhe ato të parasë elektronike, me qëllim plotësimin e nevojave të ndryshme për këto shërbime nga vetë tregu. Ligji parashikon që, për sistemet e pagesave të cilat nuk paraqesin rëndësi sistemike dhe nuk kanë veprimtari të tillë, që të aplikohet regjimi mbrojtës i krijuar nga ligji nr.133 datë 09.04.2013 "Për sistemin e Pagesave", të operojnë sisteme pagesash pa nevojën e një licence shtesë, por thjesht duke u mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë.

Nxitja e konkurrencës në një këndvështrim strategjik do të nxisë krijimin e aktorëve të rinj dhe shërbimeve të reja në tregjet financiare, në periudhën afatmesme – afatgjatë, duke kontribuar në shtimin e veprimtarisë së bankave. Nëpërmjet këtij ligji sistemi bankar mund të përshijë në veprimtari të tij edhe segmente të ekonomisë dhe të popullsisë, të cilat në kushtet aktuale të tregut duken krejtësisht të pamundura për t'u arritur nga shërbime financiare, duke përmendur si shembull

pagesën e kafesë, transportit publik, etj.

Nga ana tjetër, edhe krijimi i shërbimeve të inicimit të pagesave vlerësohet se do ketë ndikim të drejtpërdrejt në nxitjen e tregtisë elektronike dhe përdorimin e shërbime home banking, për të kryer këto pagesa. Këto shërbime, në varësi të politikave të aktorëve të tregut, mund të zhvillohen nga vet institucionet që mund të vlerësojnë shfrytëzimin e mundësive e krijuara nga ligji, për të zgjeruar bazën e ofrimit të shërbimeve të pagesave. Këto shërbime mund të ofrohen nga institucionet e pagesave, të cilat bashkëpunojnë me bankat, ose nga institucionet e pagesave të cilat nuk kanë asnjë marrëveshje kontraktuale me bankat, por që gëzojnë të drejtën të kenë akses në llogarinë e klientit të bankës nëpërmjet licencës përkatëse të marrë nga Banka e Shqipërisë dhe pëlqimin e klientit.

Forcimi i institucioneve për Mbrojtjen e Konsumatorit

Duke marrë në konsideratë faktin që, besimi i klientëve ndaj institucioneve financiare është një faktor i rëndësishëm në suksesin e veprimtarisë së tyre, ligji për "Shërbimin e pagesave" ka përcaktuar një vëmendje të veçantë këtij aspekti rregullues. Përfitimet kryesore nga mbrojtja e konsumatorit, që janë përfshirë në konceptin e konsumatorit si një opsion i propozuar nga Direktiva Evropiane, sigurisht i adresohen konsumatorëve dhe mikro ndërmarrjeve. Për arsye se këto grupe përdoruesish të sistemeve të pagesave kanë aftësi të kufizuara negociuese, e zakonisht një edukim më të ulët financiar, ligji merr përsipër zhvillimin e një kuadri për mbrojtjen e konsumatorit me mekanizma

monitorues dhe detyrues. Por, nga ana tjetër, vlerësohet se konsolidimi mbrojtjes së konsumatorit i sjell një vlerë të shtuar edhe vetë sistemit bankar e atij financiar. Kështu, ligji i ri synon të:

- zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë efektive, nëpërmjet përcaktimit të detajuar të të drejtave dhe detyrimeve të palëve,
- krijojë njësi brenda institucioneve për adresimin e mbrojtjes së përdoruesve të shërbimeve të pagesave (të ngjashme me atë të kredisë konsumatore), si dhe një njësi të posaçme brenda Bankës së Shqipërisë, për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.

Duke vlerësuar lidhjen e fortë që ka mbrojtja e konsumatorëve me ndërgjegjësimin e klientëve për të drejtat e detyrimet që kanë, edukimi i tyre financiar do të kontribuojë ndjeshëm në nxitjen e edukimit financiar të popullsisë.

Edukimi financiar është një objektiv i rëndësishëm për të gjithë institucionet e pagesave, qofshin autoritetet rregullatore ashtu dhe institucionet financiare. Për këtë arsye, ai është evidentuar si një si prioritet i rëndësishëm në Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave.

Prania e institucioneve ofruesve të shërbimeve të pagesave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Rritja e numrit të popullsisë së përfshirë financiarisht lidhet ngushtë edhe me zgjerimin e pranisë të institucioneve që ofrojnë shërbime pagese, në të gjithë territorin (përfshirë dhe zonat rurale). Mundësinë që në të ardhmen të sigurohet kjo shtrirje e

gjerë e institucioneve të pagesave në ligj është rregulluar me anë të modelit në të cilin "bankat të mund të ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve".

Aktualisht, bankat në Shqipëri operojnë nëpërmjet rrjetit të degëve, një praktikë kjo që pas efekteve të krizës financiare globale rezultoi si e kushtueshme dhe bankat, në mënyra e në masa të ndryshme, reflektuan reduktim të rrjetit të degëve dhe pranisë fizike, kryesisht në zonat rurale. Risia e prezantuar nëpërmjet ligjit vlerësohet në:

- lejimin e bankave që të shtrijnë praninë e tyre, duke bashkëpunuar kryesisht me institucionet financiare jo-banka, që aktualisht kanë një rrjet të konsoliduar agjentësh, në një mënyrë më pak të kushtueshme për to,
- digjitalizimin e shërbimeve, që nënkupton shkurtimin e dimensioneve gjeografike të kryerjes së pagesave, duke lejuar në këtë mënyrë që këto shërbime të jenë të përdorshme, edhe në rastin kur banka, ose institucioni i

pagesës, nuk ka prani fizike në një vend të caktuar. Ky zhvillim, i mbështetur edhe nga rishikimet e nevojshme rregullative për lejimin e hapjes së llogarive në distancë, vlerësohet të kontribuojë dukshëm në përfshirjen financiare të popullsisë dhe mbulimin e gjithë territorit me shërbime pagese,

- rritjen e besimit ndaj institucioneve shqiptare të pagesave në rrafshin ndërkufitar, nëpërmjet krijimit të institucioneve financiare me një qeverisje të mirë-rregulluar dhe struktura për administrimin e rrezikut. Gjithashtu, vlen të theksohet se vendosja në ligj e Direktivës PSD 2 përbën një hap të rëndësishëm për integrimin në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA) dhe hapjes së ndërveprimit në fushën e pagesave me Bashkimin Evropian.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj se, hartimi dhe miratimi i ligjit ishte një hap i rëndësishëm,

por mbeten ende shumë hapa të nevojshme për t'u ndërmarrë, nga të gjitha palët. Nga pikëpamja e Bankës së Shqipërisë, si autoriteti rregullator dhe mbikëqyrës, nevojiten energji dhe kapacitete për hartimin e akteve nënligjore, të cilat do të lejojnë zbatimin me efikasitet të ligjit. Në këtë kuadër, dëshiroj të theksoj se hapat tanë në këtë drejtim po mbështetën ndjeshëm nga përvoja evropiane dhe asistencë teknike institucioneve ndërkombëtare, duke garantuar siguri në hapat e hedhura në një terren ende të panjohur.

Zbatimi i ligjit kërkon, gjithashtu, një angazhim dhe investime të konsiderueshme edhe nga aktorët e tregut. Në këtë këndvështrim, vlerësoj se, bankat, institucionet e pagesave dhe ato të parasë elektronike, duhet të jenë të kujdesshme në vendimmarrjen e tyre, duke përfutur nga eksperiencia evropiane me qëllim maksimizimin e efekteve të ligjit, por edhe duke u kujdesur që investimet e kryera në institucionet e reja të pagesave të jenë në përputhje me standardet e kërkuara.



Ligji i ri për pagesat – sfida dhe mundësi për sektorin bankar shqiptar

BANKIERI:

1. Çfarë ndryshimesh priten të ndodhin në bankën tuaj për zbatimin e kërkesave të këtij ligji?
2. Cili mund të jetë “kërcënimi” më i madh për bankat nga prania e këtij ligji?
3. Mendoni se do të zhvillohen dhe prezantohen instrumente të reja të pagesave në Shqipëri?



Kerem PAMUK

Drejtor, Departamenti i Kartave dhe i Pagesave
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

1. Për më shumë se një dhjetëvjeçar, Banka Kombëtare Tregtare ka bërë investime të mëdha në sistemet e pagesave dhe është banka e parë që prezanton disa instrumente pagese në tregun shqiptar. Është bërë një përpjekje e vazhdueshme për të rritur vëllimin dhe numrin e transaksioneve të instrumenteve të pagesave me karta, e sidomos për të zëvendësuar parinë cash me atë jo-cash, që ofrojnë instrumentet digjitale të pagesave. Megjithatë, pavarësisht se BKT zë vendin kryesor në tregun shqiptar, për sa i përket numrit të kartave dhe terminaleve POS, mbetet ende një

rrugë e gjatë për të arritur statistikat e mesatares evropiane.

Ligji në kuptim të gjerë duket mjaft premtues, për të motivuar dhe udhëhequr njerëzit dhe institucionet financiare, për të investuar dhe përdorur sistemet financiare të pagesave, si dhe kanalet digjitale. Duke qenë se BKT ka investuar për vite me radhë në këtë fushë, do të përshtatet shumë lehtë ndaj ndryshimeve të ardhshme në treg dhe do t'i ofrojë cilësinë më të lartë klientëve ekzistues dhe atyre të mundshëm, me portofolin aktual të produkteve dhe projektet që do të përfundojnë brenda vitit.

2. Në nivel global, një nga sfidat kryesore të bankave për një kohë të gjatë është përplasja midis qasjes përcarëse të kompanive FinTech (teknologjisë financiare) dhe mënyrës tradicionale bankare. Me kalimin e kohës, të dy modelet janë ndërfutur e kanë krijuar sinergji të reja dhe aleanca shumë të suksesshme, por siç e dimë të gjithë, fazat e para të përplasjes së këtyre dy mënyrave krejtësisht të ndryshme të të bërit biznes ishin të dhimbshme, sidomos për bankat. Ndërsa ligji hap derën për kompanitë FinTech, bankat që nuk mund të marrin pozicionin e duhur, mund të vuajnë. Me siguri, kur konkurrenca midis ofruesve të

shërbimeve të rrisë më së shumti klientët/qytetarët, pritet që në një kohë mjaft të shkurtër, përdoruesit përfundimtarë të shijojnë shumë përfitime dhe zgjidhje në sistemet e pagesave.

Një tjetër kërcënim, i lidhur ngushtë me rritjen e konkurrencës, do të jetë për bankat që nuk kanë investuar sa duhet në sistemet e pagesave dhe zgjidhjet digjitale. Duke qenë se konkurrenca dhe shumëllojshmëria e produkteve do të rritet, institucionet me cilësi të dobët dhe të pakënaqshme të shërbimit do të shohin ndryshime dramatike në shifra.

3. Ne do të përballemi dhe do të shijojmë më shumë zgjidhje për pagesa digjitale dhe nëpërmjet celularëve në periudhën e ardhshme. Përvoja e përdoruesit do të përmirësohet dhe do të bëhet digjitale në fund. Ndërsa teknologjia evoluon me shpejtësi, çdo brez po përballlet disi me UX-in e ri sidomos me celularët. Depërtimi i lartë në internet dhe shifrat mahnitëse të pronësisë së pajisjeve inteligjente ndryshojnë jetën e përditshme të popullit shqiptar nga të gjitha moshat. Gjithashtu, edhe pandemia ndikoi dhe dha efektet e saj në qasjen e njerëzve drejt zgjidhjeve teknologjike të sistemeve të pagesave, siç ishin

pagesa pa kontakt dhe tregtia elektronike për blerje.

Në këtë drejtim, meqenëse legjislacioni lejon dhe drejton tregun, pritet shumë që depërtimi i pagesave nëpërmjet celularëve të jetë shumë më i lartë se sa pagesat me karta plastike. Në një të ardhme shumë të afërt, më shumë shqiptarë do të përdorin pajisjet e tyre celulare, jo vetëm për veprimtaritë e përditshme bankare, por edhe për transaksionet e pagesave.



Ardian HASA

Drejtor i Divizionit Operacional /
Anëtar i Bordit të Manaxhimit
BANKA OTP – SHQIPËRI

1. Ligji Nr. 55/2020 për shërbimet e pagesave, që ka si një nga objekt kryesor: krijimin, licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave, mendoj që ka efekt të drejtpërdrejtë mbi të gjitha bankat në dy aspekte kryesore:

- Së pari, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, bankës i shtohet një mundësi e re për të kryer një model biznesi të ri dhe duke i shërbyer klientëve në

kohë reale, pavarësisht faktit që urdhëruesi dhe përfituesi ndodhen në banka të ndryshme. Pavarësisht se një shërbim i ngjashëm sot mbulohet nga sistemi i pagesave me kartë, gjithsesi, ligji i ri për pagesat e sjell këtë në kontekstin e pagesave nëpërmjet kanaleve digjitale dhe integritit të sistemeve të bankave dhe institucioneve që operojnë në Republikën e Shqipërisë, duke i bërë kostot e pagesave brenda vendit shumë më të ulëta se ato ekzistuese dhe duke ndihmuar në zvogëlimin e pagesave cash.

- Efekti i dytë është nevoja e bankave për ndryshime dhe investime të konsiderueshme në infrastrukturën dhe sistemet ekzistuese, kjo për faktin se ligji i ri në nenin 30 të tij: "Aksesi në llogaritë e mbajtura në një bankë", që detyron bankat të japin akses në llogaritë e klientëve dhe lejojnë institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, që të ofrojnë shërbime pagesash. Këto ndryshime të pritshme dhe të detyrueshme për bankat, do të kërkojnë që bankat në vitin në vazhdim të buxhetojnë burime financiare dhe njerëzore të konsiderueshme.

Duhet theksuar fakti se një ligj i tillë është në zbatim në Evropë dhe në shumë vende të tjera dhe hyrja në fuqi e këtij ligji ka sjellë shumë ide novatore dhe ndryshime në sjelljen dhe mendimin e qytetarëve në përdorimin e shërbimeve bankare, duke përdorur kanalet digjitale tashmë të afta të ofrojnë thuajse të njëjtën gamë shërbimesh, që ofron edhe modeli tradicional me degë banke. Është shumë e rëndësishme

të nënvizojmë se, aprovimi i ligjit është veçse hapi i parë dhe është nevojë e menjëhershme që autoritetet përkatëse të vijnë sa më parë me hartimin e akteve nënligjore, rregulloreve dhe politikave, që do të bëjnë të mundur funksionimin e këtij ligji sipas afateve.

2. Personalisht mendoj që ligji nuk duhet parë si një kërcënim për bankat, por si një mundësi e mirë për të rritur veprimtarinë e pagesave dhe pse jo edhe të ardhurat nga kjo veprimtari. Është e vërtetë që ligji i ri lejon futjen në treg të aktorëve të rinj e me ide novatore, që të mbështetur edhe nga ligji, do të kërkojnë akses mbi llogaritë e klientëve ekzistues. Nga ana tjetër, në një vend si i yni ku numri i personave që kanë një llogari në bankë, në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullsisë, është i ulët, futja e aktorëve të rinj në tregun e pagesave shikohet si një element që pritet të rrisë numrin e personave që do të kenë qasje në sistemin bankar. Rritja e personave me qasje në sistemin bankar do të thotë më shumë mundësi për bankat për t'i ofruar klientëve të rinj produkte të tjera bankare, pavarësisht se nevoja e tyre primare mund të jetë qasja në sistemin e pagesave. Thënë kjo, mendoj që bankat që do të jenë më të hapura drejt ndryshimeve të pritshme dhe më të disponueshme për partneritetet me aktorët e rinj, që mund të hyjnë në treg, do të jenë më të avantazuara se bankat që mund të zgjedhin ta shikojnë praninë e këtij ligji si një kërcënim për veprimtarinë e tyre. Pra, konkluzioni im është që, sa më parë të përshtatet banka me ndryshimet që sjell ky ligj, aq më e lartë mundësia për ta kthyer "kërcënimin" në mundësi.

3. Sikurse përmenda më lart, ky ligj ekziston tashmë edhe në vende

të tjera dhe është shoqëruar me shtimin e instrumenteve të reja të pagesës. Në këtë kontekst, mendoj që edhe në Shqipëri do të ketë përshtatje të aktorëve ekzistues dhe pse jo, shtim të aktorëve të rinj, të cilët do të shikojnë me këtë ligj një mundësi të mirë, duke parë që në vendin tonë numri i përdoruesve të sistemeve ekzistuese bankare është shumë i ulët dhe, nga ana tjetër, numri i pagesave që realizohen sot në formën e pagesave në para fizike është më i lartë se ai që realizohet në formë elektronike. Të dy këto elemente krijojnë hapësira për aktorë dhe instrumente të reja. Gjithsesi, të mos harrojmë që sukcesi i këtij ligji varet edhe nga puna që do të bëjnë institucionet, për plotësimin e kuadrit ligjor që do ta bënte këtë ligj të zbatueshëm.



Gentian CAPO

Drejtor i Operacioneve
RAIFFEISEN BANK SHQIPËRI

1. Tashmë është fakt i njohur që ekonomia shqiptare karakterizohet nga problematikat e një përdorimi të lartë të parasë fizike (cash) dhe përdorimi i ulët i instrumenteve

financiare nga publiku. Në këto kushte, miratimi i ligjit të ri për pagesat, marrë në konsideratë edhe direktivën e PSD2, është i mirëpritur pasi objektiva kryesore të tij janë nxitja e përdorimit intensiv të instrumenteve moderne të pagesave, duke synuar arritjen e rreth 10 pagesave në vit "jo me para fizike" për frymë, deri në fund të vitit 2022, si dhe të shtohen mundësitë për aksesin në llogaritë e pagesave, duke arritur një raport të zotërimit të llogarisë në nivelin 70% të popullsisë madhore, deri në vitin 2022.

Për bankën tonë, si një subjekt i licencuar nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit, do të nevojiten investime shtesë në drejtim të përshtatjes së sistemeve me kërkesat e reja të ligjit, si dhe riorganizimit të strukturave organizative, sipas kërkesave të reja ligjore. Ligji parashikon kërkesa më të forta për sigurimin e transparencës ndaj klientëve, e në raport me këtë, kërkohet nga subjektet që të krijojnë struktura dhe të hartojnë procedura për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve me klientët e tyre konsumatorë. Ne po punojmë në këtë drejtim, me synimin e sigurimin të një transparence maksimale ndaj klientëve, ngritjen e strukturave të posaçme që do të mundësojnë shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve dhe bankës si ofrues i shërbimeve të pagesave.

2. Banka jonë nuk e konsideron si një "kërcënim", por një mundësi që ofron prania e këtij ligji, për rritjen e bazës së klientëve si dhe shtim të vëllimeve të pagesave. Në këtë këndvështrim, hyrja në fuqi e ligjit natyrshëm do të ndikojë në rritjen e konkurrencës midis subjekteve që do të ofrojnë shërbimet e pagesave, por nga ana tjetër, do ndikojë në rritjen

e shumëllojshmërisë së shërbimeve të pagesave, si dhe në kostot e të ardhurat e tyre. Si rezultat i uljes së komisioneve për shërbimet që do të ofrohen nga subjektet, nga njëra anë, dhe rritjes së bazës së klientëve/numrit të transaksioneve nga ana tjetër, ne vlerësojmë që efekti i ekonomisë së shkallës do të jetë pozitiv. Raiffeisen Bank është identifikuar prej fillimit si banka e risive në sistemin bankar shqiptar, duke sjellë standarde e shërbime të bankingut modern, ndaj e konsiderojmë praninë e ligjit një mundësi për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave, të mbështetur nga infrastruktura të sigurt dhe eficiente, si dhe nga një gamë e gjerë e instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave.

3. Duke njohur kostot tepër të larta që mbart përdorimi i bankave korrespondente për pagesat në valutë brenda vendit, Raiffeisen Bank inkurajon nevojën për ndërhyrje të mundshme në këtë kuadër, gjë që do sillte përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët shqiptarë, duke iu dhënë më shumë mundësi zgjedhjeje për të kryer transaksionet e tyre të përditshme, në mënyrë të lehtë e me kosto efektive.

Një tjetër zhvillim mund të ishte skema e debitimit direkt për tregun shqiptar, që do të sillte përfitime të shtuara, si nga perspektiva e konsumatorit, ashtu edhe ajo e biznesit, duke mbështetur kështu objektivin e një përfshirjeje më të gjerë financiare.

Ndërkohë, ne mendojmë se jemi të vonuar lidhur me nevojën e operacionalizimit të payroll-it kombëtar të Administratës Publike, që do të sillte rritjen e efikasitetit të tregut edhe nxitjen e mëtejshme të konkurrencës.

Zhvillimet e reja në fushën e pagesave

Një treg i hapur për konkurrencë dhe shërbim cilësor



AK – INVEST

Geis ÇEKU, MSc.
DREJTORE E DEPARTAMENTIT TË
MENAXHIMIT TË RISKUT

Liberalizimi në ofrimin e shërbimeve financiare nga Institucionet Financiare Jo-Banka (IFJB), kanë nisur zbatimin me kohë, duke krijuar klimë më të shëndetshme në tregun e konkurrencës dhe duke lehtësuar klientët në kohë, largësi dhe kosto. IFJB-të, për ofrimin e shërbimeve financiare, krijojnë rrjet të gjerë dhe intensiv (agjentësh), që është një realitet tashmë i ndërtuar e i kërkuar nga klienti, që ka ndikuar në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit të ata, nëpërmjet vendndodhjes së çdo agjenti, përpunimit të shpejtë në kohë reale të transaksioneve dhe uljes së kostove për transaksion. Rrjeti i IFJB-ve tashmë funksionon si një One-Stop-Shop për shërbimet financiare, pra klienti përfton paketë shërbimesh financiare.

Prej më shumë se 15 vitesh, AK-INVEST, i krijuar si një Institucion Financiar Universal, është përshtatur për klientët me pakicë dhe bizneset e vogla & të mesme, duke ofruar shërbime financiare, si: Kredi, Faktoring, Garanci dhe Angazhime Bankare, Pagesa (ndërkombëtare/vendase), Transferta të parave – partner i MoneyGram Int. për Shqipërinë, Pagesa, Agjent në Sigurime, Forex, Ndërmjetësim Financiar dhe Konsulencë. Tashmë si anëtar i SWIFT-it i ofrohet klientëve



Përtej përparësive të dukshme për konsumatorin, ky ligj promovon edhe një praktikë bashkëpunimi mes IFJB-ve dhe Bankave Tregtare, duke lejuar hapjen e llogarisë së pagesave dhe emetimin e instrumenteve elektronike të pagesave nga IFJB-të, pranë bankave tregtare.



të tij edhe me një përvojë në industrinë e pagesave, me njohuri dhe ekspertizë në: fushën e specializuar të pagesave lokale dhe ndërkufitare me vlerë të vogël; çështjet e pajtueshmërisë rregullatore të shërbimeve financiare - përfshirë AML/CTF, kontrollin e sanksioneve, CDD/

KYC, mbrojtjen e të dhënave dhe mashtrimet.

Miratimi i ligjit “Për shërbimet e pagesave” përafron praktikat më të mira të BE-së dhe kontribuon në nxitje të konkurrencës së lirë, integritimit me tregun unik të pagesave në Euro (SEPA¹), duke hedhur themelet e ndërlidhjes midis tregut shqiptar dhe atij evropian të pagesave. Në zbatim të këtij ligji, edhe IFJB-të (përkundrejt licencës që zotërojnë), mund të ofrojnë shërbim dhe në fushën e pagesave, e kjo risi siguron shumë përparësi për konsumatorin, pasi promovon përfshirjen financiare të konsumatorëve, që nuk kanë, ose kanë akses minimal të detyrueshëm në sistemin bankar.

Në kuadër të ndërveprimit midis institucioneve bankare dhe jo-bankare janë eliminuar praktikat bllokuese, në disa raste cënuese të konkurrencës së lirë, nga bankat ndaj IFJB-ve, si p.sh. e drejta e institucioneve të pagesave për të:

- hapur llogari pranë një banke dhe për ofrimin e shërbimeve përkatëse,
- marrë pjesë në sistemet e pagesave (drejtpërdrejt dhe tërthorazi)

Pavarësisht risive dhe aspekteve pozitive për zhvillimin e sektorit bankar dhe atij jo-bankë, bashkëpunimit mes tyre dhe lehtësirave për konsumatorin, mendoj se ky ligj ka ende paqartësi, të cilat do të përktheheshin në problematika të ardhshme në

¹ Single Euro Payment Area

zbatim. Konkretisht, referuar Direktivës (2015/2366) evidentohet:

- ekzistenca e IFJB që kanë veprimtari të pagesave, sikurse dhe veprimtari të tjera financiare.
- shërbimi i pagesave si një nënkategori e veprimtarive të ofruara dhe nga IFJB, ndërsa referuar ligjit duket si i nënkuptuar evidentimi i IFJB (prej Direktivës), por është nënvizuar si e vetmja prani (ajo) e Institucionit të Pagesave.

Nëse këtu kemi të bëjmë me devijim të ligjit nga direktiva, pra nëse kemi të bëjmë me synim të ligjit që "të përafrojë pjesërisht legjislacionin shqiptar me Direktivën 2015/2366 BE":

- Do të duhej të bëhej kujdes me shmangien e mos koherencës me Direktivën prej zbatimit të pjesëshëm të saj, gjë që mund të rrezikojë në zbatime hibride, që i hapin rrugë nevojës së interpretimeve nga nisja.
- Këto shërbime financiare, aktualisht të ofruara nga IFJB në zbatim të licencave të dhëna nga Banka e Shqipërisë dhe të gëzuara prej vitesh nga AK - Invest (p.sh.: kredia, faktoringu, garancitë, etj.), do të duhet të ruajnë të njëjtën fushë veprimi, edhe nëse emri i IFJB (kjo nuk ndodh me bankën apo IPE²) do të ndryshohet, me synimin për të shprehur një tjetër cilësi institucionale - Institucionin e Pagesës.

Sa më lart, mendoj që rregullatori dhe ligjvënësi do të duhet t'i mbajnë parasysh këto aspekte, kur të konsiderojnë ndërhyrje të tjera plotësuese në bazën rregullatore, që lidhet me pagesat në Shqipëri.

Pavarësisht nga kjo, klientët do vazhdojnë të përfitojnë nga kompetenca e burimeve njerëzore, financiare dhe teknologjike e AK-Invest, si dhe do të mund të integrohen në tregje të reja më shpejt, duke pasur mbështetje këshilluese profesionale. Monitorimi i zhvillimeve lokale, për të mbështetur inovacionin ndaj klientëve, tashmë e në vijim, do t'i shërbejë zbatimit të praktikave më të mira në marrëdhënie me partnerët bankarë.



EASYPAY

Jonida KËLLEZI
DREJTORE E DEPARTAMENTIT
TË MARKETINGUT

Pagesat, huadhënia dhe dërgesat digjitale të emigrantëve janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Në mjaft vende të botës, shumë institucione qeveritare, për të respektuar distancimin social, por edhe për t'i ardhur në ndihmë familjeve dhe bizneseve në nevojë, përdorën forma të ndryshme të pagesave dhe transfertave digjitale, për rimbursime taksash, programe sociale, paga, pensione, paketa emergjencash, etj. EasyPay, duke iu përgjigjur nevojave aktuale të

konsumatorit dhe biznesit vendas, zhvilloi dhe prezantoi në treg disa paketa shërbimesh digjitale, si:

- a) shërbimet e transfertave në kohë reale të parasë elektronike nëpërmjet celularit, duke u mundësuar individëve dhe bizneseve transferta të shpejta e të sigurta (pagesa P2P), si dhe duke u dhënë atyre më shumë lehtësi e mundësi për të zgjedhur se ku dhe kur dëshirojnë të marrin paratë, krahasuar me shërbimin ekuivalent të parasë fizike.
- b) pagesat me QR Code - tregtarët vendas, kanë mundësi të përdorin platformën e EasyPay për të shitur produktet e tyre, pa pasur nevojë që të kenë një platformë e-commerce të vetën.

Drejt së ardhmes: skenare dhe instrumente të transformimit

Situata e krijuar nga kriza e fundit, por edhe nga fakti se popullsia shqiptare ka një akses të ulët në shërbimet financiare, bëri që Komisioni për Ekonominë dhe Financat i Kuvendit të diskutonte për miratim, më 30 prill 2020, Direktivën e dytë për "Shërbimet e pagesave", i cili pritet të jetë një rregullues mjaft i mirë veçanërisht për kompanitë FinTech. Aktualisht, shërbimet nga FinTech që duhen zhvilluar me shpejtësi në tregun tonë, ndër të tjera, janë: shërbimet e pagesave digjitale, transfertat momentale të parasë elektronike, huadhënia digjitale dhe investimet digjitale.

Mirëpo, për një përfitim të suksesshëm të këtyre mundësive, kërkohet një bashkëpunim midis sistemit bankar me institucionet FinTech, pasi:

- 1) Ofrimi i pagesave në kohë reale kërkon integritet B2B dhe B2G me të gjithë shërbimet publike,

² Institucionet e Parasë Elektronike

sikurse dhe me faturimin e shërbimeve qeveritare, apo të korporatave të mëdha shqiptare. Këto integritime kërkojnë investim të madh në burime dhe teknologji, ndaj institucionet bankare mund të zgjedhin një ndër këto skenarë:

- a. ta ndërtojnë vetë këtë strukturë, e cila kërkon shumë kohë e investime nga koha e tyre, gjë që nuk është e favorshme në këtë moment ku tregu ndodhet ynë; ose,
- b. të bëjnë partneritet me institucionet FinTech në vend, të cilët tashmë e kanë gati këtë investim për klientelën e tyre.

2) FinTech-at që operojnë në tregun shqiptar, kanë ngritur tashmë prej vitesh një rrjet shumë të gjerë shpërndarje, ose agjentësh, edhe në zonat rurale, aty ku institucionet bankare nuk janë të pranishëm. Në mënyrë që të jetë eficient, ngritja e këtij rrjeti të konsoliduar kërkon sërish shumë burime, trajnime dhe ekspertizë mbi sjelljen e konsumatorit të pambulluar me shërbim bankar. Ndërkohë, sipas ligjit të ri të pagesave, institucionet bankare do të kenë mundësi të ngrenë vet një rrjet të tillë agjentësh. Mirëpo, referuar sa më sipër, për to mund të jetë më efektive dhe eficiente të zgjedhin rrugën e bashkëpunimit me institucionet FinTech në vend, të cilët mund të transferojnë (outsourc) disa nga shërbimet e tyre.

3) FinTech-at në tregun shqiptar kanë filluar të ofrojnë modele të tjera pagesash për tregtarët (p.sh.: pagesat me QR), të cilët falë teknologjisë do të zëvendësojnë modelin e

pagesave me karta. Kjo u krijon mundësinë institucioneve bankare të bashkëpunojnë me FinTech-at në këtë sektor, për të ulur kostot e tyre si dhe për të ofruar shërbimin me kosto më të ulët për tregtarët vendas, e njëkohësisht për të rritur lehtësitë për konsumatorin final.



FinTech-at në tregun shqiptar kanë filluar të ofrojnë modele të tjera pagesash për tregtarët (p.sh.: pagesat me QR), të cilët falë teknologjisë do të zëvendësojnë modelin e pagesave me karta



Përfundime

Historia ka treguar se krizat (kujtojmë krizën financiare globale të vitit 2008) janë mekanizmat e duhur për ta përsheptuar kalimin e konsumatorëve nga përdorimi i shërbimeve tradicionale financiare drejt *FinTech*-save. Përpos dhimbjeve dhe humbjeve që Covid 19 solli në botë, ai i dha *FinTech*-save një mundësi të jashtëzakonshme për të rritur në mënyrë të menjëhershme shërbimet e tyre, mbulimin gjeografik dhe imazhin. Këto arritje, që nuk u mundësuan prej disa viteve, falë pandemisë u arritën në vetëm pak muaj. *Përshtatshmëria* dhe *shkathtësia* janë dy përparësitë konkurruese të kësaj industrie, të cilat janë thelbësore për të përbulluar pasiguritë ekonomike.



FED INVEST

Pertat SULAJ
DREJTORI EKZEKUTIV

FED Invest është kooperativa më e madhe financiare në Shqipëri, me rreth 73 mijë anëtarë, banues në të gjithë Shqipërinë, që shërbehen nga 63 zyra të vendosura në zona urbane dhe rurale. FED Invest ka hapur rrugën e zhvillimit të mikrofinancës në Shqipëri dhe ka një eksperiencë 28 vjeçare në veprimtarinë e huadhënies, depozitave dhe shërbimeve këshilluese për sipërmarrësit e vegjël dhe fermerët. Sot është institucioni financiar me praninë më të madhe në zonat rurale në Shqipëri. Ky pozicionim është në harmoni me misionin e tij, për të zgjeruar përfshirjen financiare të popullsisë në zonat rurale dhe peri-urbane, duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh financiare, bazuar në teknologjitë moderne bankare.

Nisur nga nevoja e madhe e popullsisë në zonat rurale për shërbime financiare, përfshirë shërbimin e pagesave, krahas nevojës për hua dhe depozita, FED Invest ka ndërmarrë një sërë nismash në vitet e fundit për të modernizuar infrastrukturën e sistemeve dhe teknologjisë së

informacionit, me qëllim ofrimin e shërbimeve të reja financiare dhe jo-financiare. Në fillim të vitit 2020, FED Invest kaloi në sistemin e ri të TIK, një version nga më të fundit të FlexCube, si dhe u pajis me licencën përkatëse nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbimin e pagesave ndaj anëtarëve. Aktualisht jemi në fazën e testeve për produktin e pagesave utilitare, që do të jetë dhe produkti i parë i pagesave për anëtarët e FED Invest.

Me zhvillimin e teknologjive digjitale, shërbimet dhe produktet e pagesave në gjithë botën janë rritur, krahas rritjes së inovacioneve për shërbime të shpejta, të sigurta dhe me sa më pak kosto. Përfundimisht këtu nuk bën as Shqipëria, që ka njohur rritje gjatë viteve të fundit, e sidomos gjatë vitit 2020, në kushtet e pandemisë. Janë rritur numri dhe përdorimi i kartave të debitit dhe numri i transaksioneve të pagesave online. Për periudhën qershor 19 – qershor 20, numri i kartave të debitit, me të cilat mund të kryhen pagesa (në fund të qershorit 2020 këto karta përbëjnë 90.1% të të gjitha kartave me të cilat mund të kryhen pagesa) u

rrit me 6.7% dhe numri i POS-ve, për të njëjtën periudhë, u rrit me 23.7%, ndërkohë që rritja e numrit të POS-ve, vetëm për periudhën janar – qershor 2020, ishte 17.7%. Numri i transaksioneve on-line duke krahasuar qershor 2020 me qershor 2019 është rritur me 4.9%.

Pavarësisht nga kjo, duhet thënë se Shqipëria vazhdon të mbetet thuajse e fundit në Europë për shtrirjen dhe penetrimin e shërbimit të pagesave, përfshirë ato online. Kjo lidhet jo vetëm me historinë e re të ofrimit të shërbimeve bankare për popullsinë, por edhe me sfidat për formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe edukimin e pamjaftueshëm të individëve, për përdorimin e kanaleve digjitale. Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol të rëndësishëm për nxitjen dhe zhvillimin e shërbimeve të pagesave, duke përmirësuar dhe përshtatur kuadrin rregullativ për këtë qellim, e këtu një ndikim shumë pozitiv pritet të ketë dhe miratimi i ligjit të ri të pagesave. Megjithë shtrirjen e sistemit bankar dhe penetrimin e shërbimeve të tyre, kryesisht në zonat urbane në

vend, shërbimet e pagesave për zonat rurale, të ofruara nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, janë pothuaj inekzistente.

FED Invest synon që, brenda vitit, të hapë rrugën edhe për shërbimin e pagesave në zonat rurale. Ofrimi i shërbimit të pagesave utilitare është vetëm hapi i parë, pasi FED Invest ka filluar projekte të rëndësishme me partnerët e tij strategjikë, për të ofruar një gamë të gjerë të shërbimeve të pagesave për popullsinë në zonat rurale, përfshirë pagesat online. Këto projekte parashikojnë edhe fushata edukuese e ndërgjegjësuere për fermerët, për të shpjeguar dobinë e aksesit të fermerëve në shërbimin e pagesave, lehtësinë e përdorimit, uljet e kostove të transaksionit, etj. Ne besojmë se realizimi i tyre do të ndikojë jo vetëm në formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë e zgjerimin e përfshirjes financiare të zonave rurale, por edhe në krijimin e mundësive të reja për ndërhyrjen e mëtejshme të institucioneve dhe agjencive private e publike, në zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale.



10 MINUTA @ ABI BANK

RIFINANCO

KREDINË

MË LIRË

Në qoftë se keni kredi në një Bankë tjetër, vizitoni menjëherë degën më të afërt të **ABI BANK** dhe në **10 minuta** bisedë, ju mund të merrni kushte më të favorshme rfinansimi.

www.abi.al

abi AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS
investo në optimizëm

Shtatë sisteme së bashku, për një sistem pagesash efikas dhe funksional

Shoqata e Bankave Serbe zë një vend të rëndësishëm në zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe do të përfshihet në mënyrë aktive në zhvillimin e shërbimeve të reja, bazuar në zbatimin e këtyre zgjidhjeve ligjore, në përputhje me iniciativën PSD2.



Vladimir VASIĆ

Sekretar i Përgjithshëm
SHOQATA E BANKAVE SERBE

Operacionet e pagesave në Serbi realizohen nën juridiksionin e shtatë sistemeve të pagesave, që mundësojnë kryerjen e transaksioneve pa probleme, me gjendje minimale të fondeve në kanalet e pagesave. Llogaritë e bankave mbahen pranë Bankës Kombëtare të Serbisë e cila është dhe përgjegjëse për organizimin, administrimin dhe funksionimin e sistemeve të mëposhtme të pagesave:

- (1) Sistemi i pagesave ndërbankare në kohë reale: **RTGS (Shlyerja Bruto në Kohë Reale)**, që realizon pagesat që tejkalojnë e përcaktuar ligjërisht (pagesat në vlerë të madhe), në kohë reale, sipas parimit të shlyerjes bruto (shuma e plotë e secilit transaksionit individual);
- (2) Sistemi i pagesave me shlyerje ndërbankare: **Giro Clearing (GC)**, që realizon pagesat nën shumën e përcaktuar ligjërisht (pagesat në vlerë të vogël), jo të menjëhershme, sipas parimit të shlyerjes neto;
- (3) Sistemi i pagesave të drejtpërdrejta

nga llogaritë e klientëve, thuajse në kohë reale: **Sistemi i Pagesave të Menjëhershme (SPI)**, që realizon transferta sipas parimit "të menjëhershëm", d.m.th. brenda një periudhe të shkurtër kohe (afër kohës reale), nga urdhëruesi të përfituesi.

- (4) Sistemi i pagesave nëpërmjet kartës kombëtare të pagesës: **Sistemi i Kleringut DinaCard**, me shlyerje të mëvonshme, sipas parimit të shlyerjes neto.
- (5) Sistemi i pagesave për klerimin e këmbimeve valutore ndërbankare dhe ndërkombëtare (vetëm me Bankën Qendrore të Bosnjë – Hercegovinës), për realizimin e transaksioneve të pagesave në Euro.

Shoqata e Bankave Serbe, si operatori i dytë i pagesave, është përgjegjëse për sistemet e mëposhtme të pagesave:

- (1) Sistemi i pagesave për klerimin dhe shlyerjen ndërbankare nëpërmjet **çeqeve**;
- (2) Sistemi i pagesave për klerimin dhe shlyerjen ndërbankare nëpërmjet debitimit direkt.

Pjesëmarrësit kryesorë në sistemet e pagesave janë Bankat, të cilat marrin përsipër administrimin e fondeve në llogaritë rrjedhëse të klientëve. Pjesëmarrës të tjerë në sistemet e pagesave janë: Institucionet e Pagesave dhe Institucionet e Parasë Elektronike, të cilat mbajnë llogari pagese për klientët dhe ushtrojnë pjesëmarrjen e tyre në sistemet e pagesave, përmes bankave.

Në përputhje me ligjin, transaksionet

Vlera totale e transaksioneve me sistemet RTGS dhe Giro Clearing, qershor 2020, në mio EURO:

	Vlera Totale	Vlera ditore	Në %
RTGS	109,816.42	4,991.66	99.53%
Giro Clearing	346.19	15.74	0.31%
IPS	158.20	5.27	0.14%
Çeqet	18.33	0.83	0.02%
TOTALI	110,339.14	5,013.50	100.00%

*Burimi: Banka Kombëtare e Serbisë, www.nbs.rs

e pagesave realizohen si:

- Transaksione pagesash (credit transfer), bazuar në një urdhër pagese, të lëshuar nga paguesi/urdhëruesi;
- Transaksionet të detyrimeve të arkëtueshme (direct debit), bazuar në një urdhër arkëtimi të lëshuar nga përfituesi (kreditori).

Si pjesë e shërbimeve bankare, janë zhvilluar teknologji të ndryshme për depozitimin e urdhërpaguesave

Numri i pagesave nëpërmjet sistemeve RTGS Giro Clearing, qershor 2020:

	Numri total i pagesave	Numri ditore	Në %
RTGS	17,008,209	773,100	72.98%
Giro Clearing	3,747,473	170,340	16.08%
IPS	2,093,073	69,769	8.98%
Çeqet	455,423	20,701	1.95%
TOTALI	23,304,178	1,033,910	100.00%

*Burimi: Banka Kombëtare e Serbisë, www.nbs.rs

dhe dokumenteve shoqëruese, që ofrojnë një mënyrë të thjeshtë, por të sigurt, të shërbimit të faturimit dhe pagesave nga/te llogaritë e klientëve, bazuar në shërbimet për aksesimin e llogarive rrjedhëse dhe ato të biznesit, pa paraqitje në degët e bankës, si dhe shërbime faturimi dhe pagesash, teke ose të shumëfishta, në emër të dhe për klientët. Zgjidhjet teknologjike bazohen kryesisht në platformat në internet të bankave që ofrojnë shërbime elektronike, d.m.th.

zgjdhje të automatizuara për pagesa dhe transaksione të detyrimeve të arkëtueshme mbi urdhërpagesat periodike (standing orders), d.m.th. autorizime për ekzekutimin e pagesës (debitim direkt).

Këto shërbime parashikohen në legjislacion, i cili përcakton formën, kushtet, mënyrën dhe afatet për ofruesit e shërbimit të pagesave, gjatë ekzekutimit të urdhërpagesave, por edhe aspektet që lidhen me njoftimin e klientit, identifikimin e tij, mbrojtjen e të dhënave dhe interesa të tjerë të konsumatorit. Në përputhje me Ligjin për Shërbimin e Pagesave, ofruesit e shërbimit të pagesave janë të detyruar që, brenda juridiksionit që lidhet me llogaritë e pagesave, t'u sigurojnë klientëve:

(a) shërbime lidhur me hapjen, mbarëvajtjen dhe mbylljen e një llogarie;

(b) shërbime që mundësojnë kalimin e parave në një llogari pagese;

(c) shërbime që mundësojnë dërgimin e parave nga një llogari pagese në zyrën e një ofruesi të shërbimit të pagesave, ATM dhe pajisje të tjera të ngjashme, gjatë ose përtej orarit zyrtar;

(d) shërbimet e ekzekutimit të transaksioneve të pagesave nëpërmjet transferimit të autorizimit, në terminale, sportele bankare, internet dhe platforma mobile, duke përfshirë urdhërpagesat periodike;

(e) shërbimet e transaksioneve të debitimit në terminale, sportele bankare, në internet dhe platforma mobile (debitim direkt);

(f) shërbimet e ekzekutimit të transaksioneve të pagesave, duke përdorur kartat e pagesave, përfshirë dhe pagesat në internet;

(g) shërbimet e ekzekutimit të transaksioneve të pagesave me transferim thuajse të menjëhershëm të fondeve, midis urdhëruesit dhe përfituesit të fondeve (pagesa të menjëhershme).

Sistemi i Pagesave të ASB-së për Kleringun e Çeqeve daton që në fund

të vitit 2004 dhe ishte aq revolucionar për kohën sa Shoqata e Bankave Serbe mori Çmimin prestigjioz Evropian të Teknologjisë në vitin 2005 për këtë sistem, në kategorinë e "zgjdhjeve më të mira për sistemet e pagesave". Sistemi është modernizuar disa herë që nga ajo kohë dhe tani përbën themelin e pagesave me çeqe në Republikën e Serbisë.

Sistemi i ASB-së për Klerimin e Pagesave me Debitim Direkt është një sistem modern pagesash, i harmonizuar me parimet dhe standardet e Bashkimit Evropian, duke i siguruar urdhëruesit dhe përfituesit një mënyrë të besueshme për të shlyer detyrimet e ndërsjella, në mënyrë të shpejtë dhe efikase dhe në përputhje me politikën kombëtare të digjitalizimit, duke u bazuar në shkëmbimin elektronik të të dhënave, e të siguruar nga mbrojtja më moderne.

Sistemi i Pagesave të Menjëhershme (IPS) është sistemi i fundit i pagesave nën juridiksionin e Bankës Kombëtare të Serbisë, i cili hyri në funksionim në tetor 2018, e që mundëson për sa vijon:

- Disponueshmëri të transferimit të fondeve në çdo kohë (24x7x365), deri në shumën maksimale të përcaktuar;
- Ekzekutim të menjëhershëm, ose thuajse i menjëhershëm të transaksioneve dhe disponueshmëri të fondeve të përfituesit, pa mundësi revokimi (debitimi/kreditimi i llogarisë së urdhëruesit/përfituesit bëhet në kohë reale, dhe shlyerja ndërbankare mund të bëhet më pas);
- Pagesat nëpërmjet internetit dhe celularit ekzekutohen drejtpërdrejt nga llogaria rrjedhëse (jo vetëm përmes kartës).

Karakteristikat kryesore të novacioneve në pagesa janë: faturimi i integruar, bazuar në përdorimin e aplikacioneve mobile për urdhrat, pagesën dhe blerjet e integruara. Ato janë të lehta në përdorim, pasi lejojnë pagesa me

"një kontakt", pra përmes një lidhjeje të vetme (p.sh. lidhje wireless, NFC). Shumica e zgjidhjeve novatore të pagesave nuk kufizohen në një lloj pagese, duke i lejuar përdoruesit të menaxhojnë dhe të përdorin karta krediti të ndryshme, karta debiti, ose llogari pagese. Shumë zgjidhje novatore ofrojnë funksionalitete shtesë që, përveç pagesave, u mundësojnë tregtarëve dhe institucioneve financiare të ndërveprojnë më ngushtë me klientët dhe të sigurojnë vlerë të shtuar (p.sh. programet e besnikërisë, ofertat individuale, etj.). Në të njëjtën kohë, është përmirësuar siguria, duke zbatuar metoda dhe standarde të reja, që janë të disponueshme dhe lehtësisht të arritshme nëpërmjet platformave mobile (biometrike dhe identifikime të vendndodhjes, tokenizim, etj.)

Zhvillimi i mëtejshëm i kuadrit rregullator për sistemet e pagesave në Republikën e Serbisë u prezantua në Strategjinë Kombëtare për 2020-2024 nga Banka Kombëtare e Serbisë, e cila, ndër të tjera, parashikon transpozimin e Direktivës II për Shërbimet e Pagesave (PSD2) në legjislacionin kombëtar. Kjo do të inkurajojë bankingun e hapur, duke përmirësuar mekanizmin e autentikimit, duke inkurajuar sigurimin e shërbimeve të iniciuesit/grumbulluesit të pagesave dhe përmirësimin e aksesit në llogaritë e pagesave.

Shoqata e Bankave Serbe zë një vend të rëndësishëm në zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe do të përfshihet në mënyrë aktive në zhvillimin e shërbimeve të reja, bazuar në zbatimin e këtyre zgjidhjeve ligjore, në përputhje me iniciativën PSD2, siç janë: API-të, ndërfaqet e hapura dhe ndërvepruese për komunikimin midis aplikacioneve. Standardizimi i ndërfaqes API me nivelin e ndërveprimit sipas parimit A2A (llogari me llogari) në Ndërfaqen e Unifikuar të Pagesës (UPI) për komunikimin midis bankave dhe iniciuesve/grumbulluesve të pagesave mundëson realizimin e pagesave drejtpërdrejt nga llogaria e paguesit.

Pandemia, borxhi publik dhe ekonomia

Rritja e borxhit publik gjatë vitit 2020 ka qenë e pashmangshme dhe, njëkohësisht, e domosdoshme, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vendet me ekonomi shumë më të zhvilluar, të cilat nuk kishin njohur nivele të tilla borxhi, që prej Luftës së Dytë Botërore.



Intervistë me Zj. Anila DENAJ

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Në nisje të kësaj interviste do të duhet t'i bëj referencë dy qëndrimeve shumë të rëndësishme të institucioneve vlerësuese ndërkombëtare. Së pari, ai i Standard & Poors me vlerësimin **B+/Qëndrueshëm/B** (janar 2020) dhe, së dyti, ai i **Moody's** me vlerësimin **B1/Qëndrueshëm** (gusht 2020), vlerësuan reformat e qeverisë, punën ndër vite për konsolidimin fiskal dhe mbajtjen e një ekuilibri financiar, edhe gjatë një viti shumë të vështirë për financat e shtetit shqiptar, të goditura në mënyrë të njëpasnjëshme nga tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19.

Qeveria Shqiptare ka vlerësuar si prioritet konsolidimin fiskal dhe reduktimin e borxhit. Në funksion të këtij prioriteti, duke filluar që nga viti 2014, janë ndërmarrë nisma dhe veprimtari të shumta,


për të mundësuar konsolidimin fiskal të financave publike, efektet e të cilave u pasqyruan në harkun kohor të dy viteve, duke mundësuar reduktimin e borxhit publik në 66%, në fund të vitit 2019. Niveli i borxhit publik në raport me PBB-në ka vijuar të qëndrojë në këtë trajektore, deri në tremujorin e parë të vitit 2020, ndërkohë që parashikohet të ketë një rritje gjatë këtij viti. Rritja e borxhit publik gjatë vitit 2020 ka qenë e pashmangshme dhe, njëkohësisht, e domosdoshme, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vendet me ekonomi shumë më të zhvilluar, të cilat nuk kishin njohur nivele të tilla borxhi, që prej Luftës së Dytë Botërore.

Pavarësisht kontraktimit të ekonomisë përgjatë vitit 2020, pritshmëritë janë që borxhi publik t'i rikthehet trajektorës rënëse, duke filluar nga viti 2021. Kjo rritje e nivelit të borxhit është parë me skepticizëm dhe alarm, si nga bizneset, ashtu edhe nga politikanët kudo në botë, por


jo nga ekonomistët. Shumica e ekonomistëve në botë mendojnë se rritja e borxhit për të mbështetur ekonominë e vendeve, mbijetesën e bizneseve dhe punonjësve, që u mbyllën për shkak të luftës kundër përhapjes së virusit, ishte e domosdoshme.

Cila është situata e borxhit publik në Shqipëri?

Nisur nga nevojat buxhetore për financim në rritje, të shkaktuar nga tërmeti dhe pandemia COVID-19, si edhe parashikimi në rënie i PBB-së, ky raport parashikohet të rritet në rreth 80.5% në fund të vitit 2020. Në kuadrin makrofiskal, për 5 vitet e ardhshme parashikohet që të rikthehem te trajektorja rënëse, duke synuar një rikthim nën 70% të borxhit publik ndaj PBB-së, brenda vitit 2025. Vlen për t'u theksuar se, Shqipëria nuk është ndeshur me vështirësi për të siguruar nevojat e saj për huamarrje, pasi si kërkesa e tregut të brendshëm, ashtu edhe dalja në tregun e jashtëm



Kosto mesatare e borxhit shtetëror



me një Eurobond, menjëherë pas mbylljes së ekonomisë, arritën jo vetëm të përmbushin nevojat, por i siguruan ato me një kosto të njëjtë me situatën para pandemisë.

Kërkesa ka pasur një prirje për t'u orientuar në drejtim të titujve afatgjatë, duke i mundësuar qeverisë realizimin e huamarrjes në përputhje me objektivat strategjikë. Në qershor 2020 kërkesa e tregut në raport me nevojat për huamarrje ka arritur 1.79, raport të cilin Qeveria

e konsideron të kënaqshëm. Pavarësisht rritjes së stokut të borxhit në vlerë absolute dhe rritjes së përqendrimit të borxhit afatgjatë në portofol, kostot e borxhit vijojnë të jenë të ulëta, duke pasqyruar përmirësimin e raportit ndërmjet kostos dhe rreziqeve.


Portofoli i borxhit shtetëror në monedhë të huaj, gjatë viteve të fundit, ka pasur prirje diversifikimi në drejtim të uljes së peshës së monedhës Euro dhe


rritjes së peshës së monedhave të tjera. Emetimi i Eurobond-it më 16 qershor 2020 ka rritur likuiditetin, në përputhje me objektivat strategjikë për përmirësimin e strukturës së borxhit, ka shtuar mundësinë e financimit të sektorit privat nga sektori bankar, si edhe ka ulur trysninë mbi normat e interesit në tregun e brendshëm.

Kërkesa e lartë për Eurobond-in me raport mbulimi 4.3 herë shpreh interesin e tregut (investuesve ndërkombëtarë) për instrumentin, si dhe rezultojnë indikator në sigurimin e financimit me një normë më të ulët. Mbi të gjitha, kjo kërkesë rithekson besimin tek pasqyrat financiare të shtetit shqiptar dhe reformat e nisura nga Qeveria.

Huamarrja e brendshme parashikohet me rritje dhe përgjithësisht, në përputhje me objektivat për reduktimin e rreziqeve në drejtim të krijimit të madhësive "benchmark", është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandeve të titujve shtetërorë,

EUROBOND (2010-2020)





duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues.

Nr. i ankandeve sipas instrumentit të emetuar

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit është mbajtur nën kontroll, pasi stoku i borxhit shtetëror në monedhë të huaj vazhdon të qëndrojë ndjeshëm nën kufirin strategjik dhe atë të qëndrueshmërisë së borxhit. Në T2 2020 është përmirësuar struktura e borxhit publik duke rritur qëndrueshmërinë e tij:

- Është ulur rreziku i rifinancimit;

- Është ulur rreziku i normave të interesit.

Në periudhën afatmesme instrumentet afatgjatë do të vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore në portofol.

Si ka ndikuar pandemia në ekonominë e vendit?


Ndërsa vazhdon të jetë shumë e rëndësishme mbrojtja e jetës së qytetarëve dhe forcimi i sistemit shëndetësor publik, në të njëjtën kohë, duhen adresuar nevojat ekonomike të ekspozuara nga dy goditjet e njëpasnjëshme, si dhe vijimi i reformave që garantojnë

një rritje të qëndrueshme dhe të fortë.

Sipas përllogaritjeve, pritet që ekonomia shqiptare në vitin 2020 të pësojë një rënie prej 4.5-5.0% të PBB-së. Inflacioni arriti në shifrat 1.9%, kundrejt 1.1% në fund të vitit 2019. Inflacioni mbetet ende në kufij të pranueshëm, duke pasur parasysh se objektivi i Bankës së Shqipërisë prej 3%.

Niveli i papunësisë, në qershor 2020, arriti në 12% kundrejt 11.4% në fund të 2019-ës. Gjatë kësaj periudhe është luhatur numri i bizneseve që pezullohen, mbyllen

Borxhi Afatshkurtër përkundëjt Borxhit Afatgjatë në Portofolin e Borxhit Publik



Me **BKT Smart** në dorën tuaj
ju jeni në **duar të sigurta!**



i sigurt



i shpejtë



kudo



kurdo



Aplikacioni bankar Nr. 1 në Shqipëri



BKT
BANKA KOMERCIARE TREGTARE



4 22 66 288 | www.bkt.com.al

apo rihapen, duke treguar qartazi një lloj pasigurie për të ardhmen. Të njëjtën gjë tregon edhe numri i punonjësve që largohen nga puna dhe pastaj ripunësohen. Vlen të theksohet se këta tregues janë ende në fazën e një analize afatshkurtër dhe se vet bizneset po vlerësojnë ndikimin që pandemia po manifeston çdo ditë. Megjithatë, në vazhdimësi ne kemi parë sinjale pozitive nga sektorë të ndryshëm.

Me paketat mbështetëse financiare, qeveria shqiptare, ashtu siç ndodhi në ekonomitë e tjera kudo në botë, kishte për qëllim mbështetjen e menjëhershme dhe sigurimin e konsumit të domosdoshëm për shtresat më në nevojë. Rreth 250 mijë persona përfituan nga pagesa e drejtpërdrejt me paketat 1 dhe 2. Garancitë shtetërore të ofruara për bizneset, synojnë mbështetjen e bizneseve në planet e tyre afatshkurtra, deri sa situata të qartësohet. E ndërsa afatet janë ende të papërfunduara, janë mbi 600 biznese që kanë përfituar nga të dy garancitë e ofruara dhe janë rreth 13 miliardë lekë të aprovuara deri në fund të gushtit.

Në korrik 2020, Qeveria mori edhe disa masa të tjera, të cilat vendosën në fokus biznesin e vogël, duke rritur pragun e TVSH-së për biznese me xhiro mbi 10 milionë lekë dhe zeruar tatimitimin për të gjitha bizneset me xhiro vjetore deri 14 milionë, deri në vitin 2029. Paketat për nxitjen e punësimit janë lançuar në muajin shtator dhe ende po punohet për të lançuar politika mbështetëse për biznesin.

Një shqetësim i përbashkët i vendeve në zhvillim mbetet fakti që, për shkak të informalitetit të lartë, mbeten pa trajtuar me ndihmë humanitare punonjësit dhe bizneset informale.

Po ringritja e ekonomisë?

Më 27 maj 2020, Bashkimi Evropian miratoi "Next Generation EU recovery plan" me një buxhet prej 2 trilionë Euro, me qëllim ringritjen e ekonomisë në vendet anëtare të BE-së. Ndërsa në fillim mendohej që rënia ekonomike do të ishte në nivelin 7.4%, tashmë pritet që ajo të jetë të paktën 8.3% në BE. Kjo situatë e pazakontë dhe e paprecedentë ka bërë që shpesh edhe parashikimet të mos jenë të mundura. Në prezantimin e këtij plani në Komisionin Evropian, Presidentja zj. Ursula von der Leyen tha: "Plani i rimëkëmbjes e kthen sfidën e madhe me të cilën përballemi, në një mundësi, jo vetëm duke mbështetur rimëkëmbjen, por edhe duke investuar në të ardhmen tonë: Marrëveshja e Gjelbër Evropiane dhe digjitalizimi do të rrisin vendet e punës dhe rritjen ekonomike, qëndrueshmërinë e shoqërive tona dhe shëndetin e mjedisit tonë." Është e qartë se mbrojtja e mjedisit dhe digjitalizimi i ekonomisë janë dy drejtimet kryesore nga të cilat do të kalojë ringritja e ekonomisë në vendet e BE-së.

Krahas pjesëmarrjes në nismat evropiane dhe procesin e integritimit evropian, Qeveria ka hartuar edhe planin e saj për ringritjen ekonomike dhe besojmë se do të japë rezultate të shpejta që në vitin 2021, kur është parashikuar që ekonomia jonë të rritet mesatarisht me 4.5% çdo vit, në tre vitet e ardhshme.

Disa nga nismat të cilat do të na ndihmojnë në ringritjen nga pasojat e Covid-19 janë:

1. Plani i rindërtimit nga pasojat e tërmetit, i cili pritet t'i japë shtysë të konsiderueshme sektorit të ndërtimit, si edhe rritjes së punësimit. Krijimi i zonave të reja urbane me

standardet më moderne do na japë mundësinë e futjes së teknologjive më të reja, në fushën e transportit, eficensës së energjisë, etj.

2. Projekte të rëndësishme në fushën e energjisë së rinovueshme, duke u fokusuar gjithmonë e më tepër në energjinë diellore (shembull konkret është Parku Fotovoltaik i Karavastësë), ku ende kemi një potencial të madh të pashfrytëzuar; projekte të rëndësishme infrastrukturore.
3. Stimulimi i klimës së biznesit. Krahas lehtësimit të barrës fiskale për 91% të bizneseve të regjistruara në Shqipëri, duke besuar se mund të jetë një nxitës i mirë për rritjen e numrit të tyre si edhe të vetëpunësimit, në fokus do të jenë edhe politikat afatmesme fiskale për një konsolidim afatmesëm.
4. Fuqizimin e të gjitha strukturave të arsimit dhe formimit profesional, për të përgatitur punëtorë të kualifikuar, për t'iu përgjigjur nevojave të reja të tregut të punës.
5. Nxitja e inovacionit, krijimi i tech hubs, fondeve rajonale për mbështetjen e inovacionit si edhe fuqizimi i arsimit profesional në fushën e ICT-së.

Realizimi i të gjitha këtyre nismave, patjetër që kërkon edhe bashkëpunim dhe entuziazëm nga të gjithë aktorët e tjerë të tregut, siç janë bankat, bizneset dhe çdo qytetar i këtij vendi.

INTERVISTA

UNION BANK – të përkushtuar për automatizimin dhe modernizimin e shërbimeve bankare

Ne synojmë që në të ardhmen shërbimin ndaj klientit ta realizojmë edhe më të personalizuar. Kjo do të sjellë një ndryshim strategjik, që do të pasqyrohet dhe në ndryshim të proceseve të organizimit të bankës.



Flutura VEIPI

Drejtoresh e Përgjithshme Ekzekutive
UNION BANK

Ju keni pak kohë që jeni emëruar Drejtoresh e Përgjithshme Ekzekutive e Union Bank dhe u përballët thujtse menjëherë me pandeminë COVID-19. Sa sfidues është ky pozicion në kushtet aktuale dhe përgjatë “normales së re” brenda sektorit bankar dhe sistemit financiar shqiptar?

Rrugëtimi im në Union Bank ka nisur në vitin 2016, si Anëtare e Bordit Drejtues të bankës. Gjatë këtyre viteve kam qenë pjese e progresit dhe arritjeve të Union Bank, të cilat vitet e fundit kanë qenë mjaft pozitive. Me ardhjen në pozicionin e Drejtoresh së Përgjithshme Ekzekutive erdhën shumë shpejt edhe sfidat, ku ajo më kryesorja ishte dhe vazhdon të jetë menaxhimi i situatës së pandemisë dhe sigurimi i vazhdimësisë së veprimtarisë së bankës.

Prioritare në kushtet aktuale për mua ka qenë siguria e stafit dhe klientëve, fokusi në adresimin e

shqetësimit personal të punonjësve, qëndrimi pranë duke dhënë mbështetje maksimale si dhe mesazhe pozitive, pasi kjo nuk është një ngjarje që ka sjellë ndryshim të paracaktuar për sistemin bankar; është një pengesë momentale, që na ka detyruar të përshtatemi, të gjejmë drejtimin e duhur dhe të vazhdojmë rrugën.

Pandemia ndodhi në javën e dytë të marrjes së detyrës dhe kjo padyshim ishte sfidë për mua. Njohja nga afër me institucionin dhe rolet e gjithkujt, në çdo ndryshim, kërkojnë kohën e tyre dhe në situatën



Ne jemi gjithmonë në kërkim të përmirësimit të produkteve dhe shërbimeve, ku përveç përmirësimit më të fundit të platformës e-banking dhe mobile banking, kemi dhe një sërë projektesh të lidhura me sistemin e bankës, të cilat do t'u shërbejnë dhe do të mbështesin planet e biznesit, si dhe do të ndihmojnë në automatizimin dhe modernizimin e një pjese të madhe të operacioneve të bankës, në Zyrat Qendrore dhe rrjetin e degëve.



që u gjendëm nuk kishte kohë për përshtatje të natyrshme. Një drejtues ka përgjegjësi primare të marrë vendime dhe të orientojë stafin drejt

të ardhmes, akoma më shumë në momente pasigurie, ku kërkohet dhe më shumë orientim, e pavarësisht se sa kohë ke në këtë detyrë, nuk e ndryshon dot nevojën që të tjerët kanë për ty dhe përgjegjësinë personale.

Megjithatë, pavarësisht ndikimit të përgjithshëm, banka ka arritur të jetë e suksesshme në përballimin e çdo dite që nga muaji mars, duke qenë në punë dhe operacional për të gjithë klientët. Kemi vijuar të jemi me rritje në të gjithë treguesit, të kemi gjithashtu përfitueshmëri, duke mbështetur me financime shtesë dhe klientë të prekur nga pandemia, për të siguruar baza më të forta për një stabilitet të rritur në të ardhmen, pavarësisht pasigurisë që ekziston. Çdo gjë e përmendur më sipër ka qenë e mundur falë mbështetjes së stafit të bankës dhe bashkëpunëtorëve më të afërt, të cilët kanë qenë burimi më eficient i informacionit.

Besimi i i klientëve të banka dhe besimi i stafit të unë, që mundem t'i drejtoj edhe në të tilla sfida, është fuqia që çdo drejtues ka, personalisht forca dhe energjia më e madhe në këtë situatë.

Përtej sfidës së pandemisë COVID-19, cilat janë disa prej prioritetëve dhe objektivave që Union Bank synon të realizojë nën drejtimin tuaj?

Union Bank, në vitet e fundit, ka ruajtur një ritëm rritjeje të lartë dyshifrore dhe gjatë 7-mujorit të parë për vitin 2020 u rendit ndër bankat me rezultate më të larta, pavarësisht situatës të pafavorshme për biznes, të krijuar nga pandemia. Ne kemi dëshmuar dhe njëherë

qëndrueshmërinë dhe angazhimin tonë si bankë për të vazhduar me seriozitet dhe këmbëngulje misionin tonë në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve bankare cilësore dhe eficiente për klientët tanë. Për këtë jemi të ndërgjegjshëm që nuk ka për të qenë e lehtë, pasi ndikimi i pandemisë do të sjellë efekte në ekonomi dhe në ecurinë e klientëve tanë. Ndonëse është e vështirë të bëhen parashikime të sakta, ne vijojmë të shohim me pozitivitet dhe të angazhohemi çdo ditë të shohim përtej, duke marrë masat për të qenë të mirë përgatitur për t'u përballur me ndikimin e kësaj situatë.

Pra është e pashmangshme që fokusi këtë vit vijon të jetë menaxhimi i kostos së pandemisë, e shprehur dukshëm në rritjen e portofolit të huas me probleme, me ndikim në rritjen e kreditimit, por dhe në likuiditet, për hir të mungesës së turizmit në vend në nivele të ngjashme me vitet e mëparshme dhe mosardhjes së emigrantëve këtë verë, si dhe uljes së konsumit në masë.

Megjithatë, drejtimi i kësaj situatë nga ana jonë është bërë pa u shpëputur dhe duke punuar në linjë me vizionin e qartë të pozicionimit të Union Bank në treg, si një bankë me shërbim cilësor dhe me fokus te klienti, duke krijuar një marrëdhënie afatgjatë me të. Ne synojmë që në të ardhmen shërbimin ndaj klientit ta realizojmë edhe më të personalizuar. Kjo do të sjellë një ndryshim strategjik, që do të pasqyrohet dhe në ndryshim të proceseve të organizimit të bankës.

Aktualiteti, por më shumë dhe e ardhmja, kanë sjellë sfidën e digjitalizimit në dyert e sistemit bankar. Edhe pse një vend i vogël dhe me një ekonomi ku transaksionet në cash mbeten në pozita të forta dhe pa ndryshime të dukshme në

vite¹, do të ketë gjithnjë e më shumë përpjekje në kanalizimin e tyre në sistemin bankar, ku më e dukshme është sjellja ndaj pagesave online, gjithmonë e më shumë në rritje dhe numri i lartë i klientëve që shërbehen në kanalet digjitale. Situata e krijuar nga COVID-19 këtë nevojë e nxori më shumë në dukje dhe e ktheu në një stimul, që edukoi deri diku edhe klientët më rezistentë. Këto platforma janë një vlerë e shtuar në administrimin e kohës së klientit, ofrojnë më shumë mundësi shërbimi, pasi shërbehet gati pa kufij kohor dhe nga kudo ku klienti ndodhet. Ato kanë gjithashtu dhe përfitueshmëri në strukturën e kostove bankare për klientin. Sigurisht që kontakti njerëzor është i rëndësishëm, por vlera e tij është në një këshillim, plotësim informacioni, që klienti të bëjë zgjedhjen e duhur dhe me bindje.

Ne synojmë të ndërtojmë një bankë që është tërheqëse dhe për brezin e ri, ose gjenerata e njohur si Gen-Z² të cilët kanë sjellje tjetër, të ndryshme nga prindërit e tyre, që sot janë klientët bazë të sistemit bankar, por që janë një gjeneratë globale dhe që ndryshojnë shumë pak në sjellje nga njëri-tjetri, pavarësisht vendit ku jetojnë.

Si e vlerësoni ju pozicionimin e Union Bank në sektorin bankar shqiptar dhe në sistemin financiar, lidhur me produktet dhe shërbimet bankare?

Siç e theksova dhe më lart, Union Bank ka pasur vitet e fundit një ecuri mjaft pozitive, çka e ka mirë pozicionuar atë në sistemin bankar. Gjatë vitit 2019, banka regjistroi një nga vitet më të mira në historinë e saj 15-vjeçare. Rritja erdhi sigurisht falë blerjes së Bankës Ndërkombëtare Tregtare, por kryesisht ishte edhe

falë vijimësisë së rritjes organike të Union Bank. Mbështetur në të dhënat financiare, Union Bank arriti gjithashtu edhe fitimin më të lartë historik, me thuajse 800 milionë lekë neto. Me këtë shifër, Union Bank siguroi një kthim nga kapitali në nivelin 17.71%, duke qenë kështu banka e dytë më fitimprurëse në Shqipëri për vitin e kaluar.

Finalizimi i blerjes së Bankës Ndërkombëtare Tregtare (ish ICB) solli një rritje të aktiveve, që kontribuuan ndjeshëm në rritjen e përmasave të Union Bank, pas shkrirjes mes dy bankave. Aktualisht, Union Bank ka një strukturë aktivesh të ekuilibruar, midis ekspozimit ndaj sektorit privat dhe atij publik.

Lidhur me produktet dhe shërbimet, ne jemi gjithmonë në kërkim të përmirësimit të tyre dhe përveç përmirësimit më të fundit të platformës e-banking dhe mobile banking, kemi dhe një sërë projektesh të lidhura me sistemin e bankës, të cilat do t'u shërbejnë dhe do të mbështesin planet e biznesit, si dhe do të ndihmojnë në automatizimin dhe modernizimin e një pjese të madhe të operacioneve të bankës, në Zyrat Qendrore dhe rrjetin e degëve.

Për sa i përket produkteve standarde bankare, në huadhënie ne synojmë të ruajmë parametrat tona të qëndrueshëm dhe të vazhdojmë rritjen, me fokus të veçantë te individët dhe bizneset NMV. Theksoj se, në të njëjtën kohë, banka do të rishikojë rregullisht dhe do të monitorojë të gjitha ekspozimet dhe rreziqet, duke u përpjekur të ruajë cilësinë e mirë për portofolin e huas. Edhe struktura aktuale e fondeve do të jetë gjithashtu e vëzhguar me shumë kujdes, kundrejt produkteve të ofruara nga banka, që janë dhe baza për strukturën e kostos së fondeve.

¹ Paraja jashte sistemit bankar është gati 40% relative me M2, bazuar në burimet e Bankës së Shqipërisë: www.bankofalbania.org/statistikamonetaredhefinanciare/

² Brezi i lindur në vitet 1996-2015.

Bankat – një realitet i domosdoshëm për ekonominë dhe shoqërinë

Bankat jo vetëm që nuk e kanë ndërprerë kontributin e tyre në shoqëri dhe në ekonomi duke luajtur rolin e tyre të ndërmjetësit financiar, por kanë ri siguruar një element shumë të rëndësishëm në këtë situatë të rënduar: qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar të vendit.



Dr. Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE, AAB

Pandemia e COVID-19 pati një efekt shumë dimensional: shëndetësor, psikologjik, ekonomik, social, me pasoja të ndjeshme negative, kohështrirjen e të cilave nuk mund ta pohojmë me saktësi. COVID-19 vuri në provë çdo sektor, çdo qëndrueshmëri, çdo sistem. Ku më pak e ku më shumë, situata është e rënduar.

Sektori financiar nuk mund të mbetet jashtë kësaj situatë. Ai noton në këtë cunam COVID-19, bashkë me të gjithë ekonominë. Këtu janë bashkë financat dhe prodhimi, shërbimet dhe konsumi. Aq e fortë është lidhja sa rënia e njëres tërheq tjetrën. Zinxhiri duhet mbajtur i pashkëputur, përndryshe pasojat do të jenë edhe më shkatërruese e të dhimbshme.

Bankat nuk mund të jenë në një situatë më të relaksuar se sa bizneset e tjera. Megjithëse janë

më të mirë organizuara, zbatojnë parimet e përparuara të qeverisjes së korporatës, kontrollohen e mbikëqyren nga institucion i specializuar, kanë kuadër ligjor specifik – të gjitha këto ndikojnë në amortizimin më të mirë të goditjeve, por ato janë atje, nën një rrezik edhe më të shtuar. Kjo, sepse bankat nuk mendojnë thjesht për vete. Bankat nuk mund të shpëtojnë nëse ekonomia rrënohet, nëse rënia ekonomike shkatërron bizneset dhe individët. Përveç goditjeve si çdo biznes tjetër që ka të bëjë me masat për mbrojtjen e punonjësve dhe logjistikën e vet të



Bankat nuk mund të shpëtojnë nëse ekonomia rrënohet, nëse rënia ekonomike shkatërron bizneset dhe individët. Përveç goditjeve si çdo biznes tjetër që ka të bëjë me masat për mbrojtjen e punonjësve dhe logjistikën e vet të biznesit, bankat duhet të mendojnë për ecurinë e klientëve të tyre.



biznesit, bankat duhet të mendojnë për ecurinë e klientëve të tyre. Ecuria e klientëve huamarrës është thelbësore në efektin mbi depozitat, si fonde financimi. Mbrojtja dhe siguria e depozitave është bazë e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare.

Ja pse bankat, në këtë situatë, objektiv parësor nuk kanë fitimin;

fitimi i tanishëm do të ishte afatshkurtër, iluzion, kurse kapërcimi i situatës dhe rifillimi i jetës ekonomike sa më gjerë, e sa më thellë, do të ishte garancia e suksesit dhe stabilitetit. Pikërisht se është kuptuar në këtë mënyrë dhe vlerësohet maksimalisht në këtë rëndësi pa bankat nuk reshtën financimin dhe zgjidhjet relaksuese, për biznesin dhe individët, gjatë kësaj periudhe. Dy shtyrjet e kësteve të huave, që u ofruan me mundësi zgjedhje nga huamarrësit (rikompozim të madhësisë së këstit brenda të njëjtit afat maturimi, ose shtyrje e afatit të maturimit për aq muaj sa u bë shtyrja), sipas një vlerësimi nga AAB, rritën likuiditetin në treg me rreth 110 milionë euro (ose mbi 13 miliardë lekë). Shifrat e tremujorit të dytë tregojnë rritje të kreditimit, edhe pse në kushte shumë të vështira të parashikimit dhe besueshmërisë afatshkurtër. Në fund të qershorit kredia për ekonominë arriti në 591 miliardë lekë, nga 576 miliardë lekë në fund të vitit 2019.

Këto të dhëna tregojnë se bankat nuk kujdesen për të shpëtuar veten, apo për të zgjidhur hallet e tyre, jashtë asaj që po vuan ekonomia. Bankat jo vetëm që nuk e kanë ndërprerë kontributin e tyre në shoqëri dhe në ekonomi, duke luajtur rolin ndërmjetësit financiar, por kanë ri siguruar një element shumë të rëndësishëm në këtë situatë të rënduar: qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar të vendit. Sigurimi i shërbimeve, ofrimi i produkteve, qasja online në këto shërbime dhe produkte, pranimi i

aplikimeve për hua, trajtimi i tyre, stabiliteti i depozitave – të gjitha këto janë fakte pozitive se bankat nuk “qajnë” hallin e tyre, por ato janë në të njëjtën varkë me gjithë ekonominë dhe secili kontribuon sipas rolit dhe peshës së vet.

Pandemia, për shkak të masave të forta të mbylljes, nxori në pah nevojën e përdorimit dhe familjarizimit të shërbimeve online – të ofruara nga sektori privat dhe ai publik. Bankat kanë vite që ofrojnë online banking, nëpërmjet kompjuterit dhe celularit. Është investuar shumë për këtë infrastrukturë dhe është bërë shumë marketing për njohjen, familjarizimin dhe përdorimin – e shoqëruar kjo edhe nga një kujdes për mënyrën e mbrojtjes nga sulmet kibernetike. Të ndodhur në kushtet e mbylljes, më shumë se një hobby, njerëzit u detyruan të merren me shërbimet online. Detyrimi që shumë shërbime duheshin kryer nëpërmjet e-albania, ndihmoi në zhdërvjelltësimin e aftësive kompjuterike, nxjerrjen e frikës dhe qasjen më të sigurt ndaj teknologjisë. Por sërisht, përdorimi i e-albania nuk është si përdorimi i llogarisë bankare, ku një gabim mund të të kushtojë shtrenjtë. Ende ka nevojë për shumë edukim dhe shumë më tepër përdorim të shërbimeve digjitale nga klientët e bankës. Pra, ndodhemi në një moment që si shërbimet publike dhe ato private duan më shumë teknologjinë. Mirë se erdhëm në këtë pikë takimi! Sepse ishim gati të vetmit, që për vite me radhë, po nxisim përdorimin e shërbimeve online dhe pagesave me kartë, jo në para fizike.

Bankat u dhanë mundësi klientëve të tyre që, duke ruajtur veten në kushtet e mbylljes nga pandemia dhe të mos kufizimit të shërbimeve të tyre jetësore, të përdorin gjerësisht bankingun digjital. Për më tepër, ato hoqën dhe komisionet për një periudhë kohe, e kjo jo sepse nuk shkonte njeri në bankë (nuk mund të

pohohet kjo kur bankat u kritikuan pse kishin radhë me njerëz gjatë pandemisë), por sepse bankat nuk donin që njerëzit të dilnin jashtë e të thyenin rregullat e vendosura të mbylljes, gjatë pandemisë. Qëndro në shtëpi dhe përdor bankën digjitale! – kjo ishte moto e bankave. Bankat jo vetëm që ofrojnë shërbime digjitale, por edhe produktet teknologjike i kanë shtuar e përmirësuar. Ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në vendet e zhvilluara, brenda afateve, zbatohen edhe nga industria jonë bankare. Së fundi, prezantimi i kartës pa kontakt është kryer brenda afateve kohore të diktuar nga shoqëritë që ofrojnë transferimin elektronik të fondeve. Karta e studentit, karta e rimbushjes, limitet në internet – janë produkte të tjera të ofruara, edhe pse jo në mënyrë uniforme, nga të gjitha bankat. Pretendimi dhe kërkesa se mund të ecet dhe më shpejt dhe me më shumë krijimtari në këtë drejtim është e mirëpritur dhe e vlerësuar, por pa harruar kërkesën e tregut për to. Ende jemi në nivel të ulët të përdorimit të kartës së debitit si kartë pagese; ajo përdoret kryesisht për të tërhequr pagën në ATM.

Që bankat janë sektori avangarde i ekonomisë dhe shoqërisë sonë, kjo pranohet jo vetëm në nivel akademik e institucional, por edhe në atë popullor (anketime të ndryshme e nxjerrin industrinë bankare si industrinë më të besueshme në vend). Asnjëherë nuk kemi pretenduar se është sektor i përsosur, madje gjithmonë nënvizojmë faktin se kjo industri e zhvillon veprimtarinë e saj me njerëz nga kjo shoqëri, me institucionet si për gjithë bizneset e tjera, me kulturën që mbizotëron në treg, me njohuritë financiare të popullatës ende në nivel të ulët, e brenda klimës së biznesit që karakterizon ekonominë shqiptare. Pra, është e pamundur të mos ndikohet nga këto fenomene, për mirë apo për keq, madje të gjenden dhe raste që janë të

papranueshme. Gjithsesi, kjo nuk i ul vlerën sektorit. Të bashkëjetosh dhe të dish të ndërhysh për mos preken e standardit është aftësi e spikatur, të paktën, deri tani e industrisë bankare. Përtej kritikave dashamirëse dhe konstruktive, por edhe ndonjë rasti që ndoshta merr më shumë vëmendje, sidomos në rrjetet sociale, bankat kanë ditur gjithmonë të reagojnë me racionalizëm dhe profesionalizëm, pa bërë kurrë kompromis me parimet bankare dhe standardet e përparuara të veprimtarisë bankare. Nëse nuk i përgjigjemi çdo sulmi kritik, kjo nuk do të thotë se nuk i lexojmë dhe nuk mbajmë qëndrimin tonë, prandaj, kushdo qofshi JU (politikan, blogger, gazetar, analist, biznesmen, qytetar i thjeshtë, etj.) që mund të sulmosh bankat, nuk mund ta bësh këtë se kështu ju vjen për mbarë, apo me lehtësinë që flet për politikën, ose sportin. Sektori financiar është përfaqësim tipik i shprehjes: “një edhe një bëjnë dy”!

Së fundi, dëshiroj ta mbyll me një citim nga fjala e Guvernatorit Z. Gent Sejko, mbi vendimmarrjen e politikës monetare mbajtur në datën 5 gusht 2020:

“Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se sektori bankar ka dhënë një kontribut të qenësishëm në drejtim të amortizimit të goditjeve. Kredia për sektorin privat vijoi të shënojë rritje në tremujorin e dytë, duke kulmuar në nivelin 7% në muajin qershor dhe duke i mbështetur bizneset dhe familjet shqiptare me likuiditetin e nevojshëm për përballimin e krizës. Gjithashtu, ky sektor ka marrë mbi vete një pjesë të kostos financiare të goditjes, duke lehtësuar më tej barrën për sektorin privat. Këshilli Mbikëqyrës vëren se vijimi i kësaj përjasje pozitive të sektorit bankar ndaj kredisë, e cila është favorizuar dhe nga instrumentet e garancisë sovraane, do të jetë një parakusht i nevojshëm për rikuperimin e ekonomisë në të ardhmen.”

Përtej moratoriumit të kësteve të huave

Çështje për t'u adresuar dhe menaxhuar nga sektori bankar

Gjatë muajve të fundit, bankat janë përshtatur me dinamikën e re, ndërkohë karakteristikat unike të recesionit i kanë detyruar të lëvizin më shpejt, për bërë analiza në kohë sa më reale, sa i përket vendimmarrjes për hua.



Admira LLAZARI

Drejtuuese e Departamentit të Riskut të Kredisë
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Mbarë bota po përjeton një situatë të paprecedentë, ku shumë shpejt emergjenca parësore në shpëtimin e çdo jete njerëzore, nëpërmjet masave kufizuese të karantinimit masiv dhe distancimit social, u pasua nga kolapsi ekonomik. Pa dyshim, Covid-19 konsiderohet si një ndër krizat më të rënda që ka përjetuar njerëzimi ndër shekujt e fundit.

Në nivel global, recesioni ekonomik parashikohet ta kalojë shifrën 5%, shifër shumë më e rëndë se pasojat e Depresionit të Madh të viteve 1929-1933, apo krizës financiare të vitit 2008. Ndërkohë, për vendin tonë parashikohet një rënie prej 9%, e cila është ndër më të lartat në rajon, për shkak të modelit

ekonomik, bazuar kryesisht te bizneset e vogla, tregtia dhe shërbimet, varësisë së lartë nga turizmi, rënies së dërgesave të emigrantëve dhe investimeve të huaja direkte, pasojave të tërmetit si dhe borxhit të lartë publik, i cili i lejoj shumë pak hapësirë fiskale qeverisë që të mbështeste bizneset dhe sektorin privat.

Tashmë kryefjala është si të stimulohet rimëkëmbja ekonomike dhe strategjitë, politikat e lehtësirat fiskale, që duhen aplikuar në këtë drejtim. Edhe në nivel global ka shumë debate nëse



Në një ekonomi që vijon të përjetojë një trysni mjaft të lartë mbi kapacitetin tashmë të kufizuar fiskal për të trajtuar nevojat urgjente të shëndetit publik dhe shoqëror, pasiguria, mos-rikuperimi i vendeve të punës si dhe ngadalësimi i ritmit ekonomik, do vijnë të transmetojnë efektet e tyre në shlyerjen e kësteve të huave.

rimëkëmbja ekonomike do të ketë një formë V-je, duke treguar një rënie ekonomike afatshkurtër me një kthim të shpejtë në nivelet e

mëparshme të prodhimit, ose nëse rikuperimi do të zgjasë më shumë, duke ndjekur një formë U-je; a po mund të jetë më shumë si një formë L-je, rimëkëmbja e së cilës do të kërkojë shumë vite, apo edhe dekada.

Klientëve huamarrës iu ofruan ri skedulime të kësteve, apo modifikime të planit të shlyerjes së huas, me qëllim mundësimin e rimëkëmbjes së tyre. Deri më tani, shtyrja e kësteve, stimujt fiskalë dhe mbështetja e qeverisë kanë ndihmuar, por nuk janë të mjaftueshme. Afati i moratoriumit mbi mos-pagesën e kësteve ka përfunduar dhe klientët filluan me pagesat e tyre në shtator. Gjatë gjithë kësaj periudhe jemi angazhuar për të mbështetur të gjitha kërkesat, vlerësuar ndikimin e situatës mbi aftësinë paguese dhe përshtatjen e zgjidhjeve, me qëllim mundësimin e rimëkëmbjes të veprimtarive të klientëve tanë huamarrës. Me gjithë kompleksitetin voluminoz të gjithë procesit, duke mbajtur në vëmendje pasigurinë dhe paparashikueshmërinë e kohëzgjatjes së pandemisë, si dhe nëse do ketë një valë rikthimi, zgjidhjet e ofruara kanë qenë individuale, në linjë me situatën dhe pritshmëritë e secilit klient për rimëkëmbje. Gjithashtu, kemi pasur një qasje më specifike për ata klientë që kanë shfaqur vonesa edhe para pandemisë. Nisur nga



shpërndarja e portofolit, 85% e kërkesave janë paraqitur nga individët, por në volume, janë bizneset ato që mbajnë peshën më të lartë. Pavarësisht se, thuajse të gjitha këto kërkesa tashmë janë adresuar dhe aplikuar në sistemin e bankës, sfidat që na presin përsëri mbeten të shumta. Moratoriumi në vetvete siguroi likuiditet në duart e huamarrësve, e përsëri rimëkëmbja e bizneseve dhe individëve mbetet një sfidë. Sektori i transportit, turizmit, i zinxhirit të shërbimeve të bareve e restoranteve, fasonët dhe tregtia me pakicë, të cilët janë gjithashtu punëdhënës të një numri mjaft të konsiderueshëm të popullsisë aktive, vijojnë të mbeten ndër sektorët më të ndikuar negativisht e, për rrjedhojë, edhe rikuperimin do ta kenë më të vështirë. Konsideruar situatën aktuale, rënien e vëllimit të veprimtarisë ekonomike, rritjen e papunësisë, shkallën e lartë të informalitetit, financat e brishta, rritjen e borxhit publik dhe mungesën e investimeve, ecuria e ekonomisë sonë dëshmon se rimëkëmbja do të jetë një proces i vështirë dhe i ngadalhtë.

Në një ekonomi që vijon të përjetojë një trysni mjaft të lartë mbi kapacitetin tashmë të kufizuar fiskal për të trajtuar nevojat urgjente të shëndetit publik dhe shoqëror, pasiguria, mos-rikuperimi i vendeve të punës si dhe ngadalësimi i ritmit ekonomik, do vijojnë të transmetojnë efektet e tyre në shlyerjen e kësteve të huave. Një valë e re e ekspozimeve me probleme mund

të fillojë dhe duhet të adresohet. Rehabilitimi i portofoleve kërkon monitorim të ngushtë dhe nxitje të marrëdhënieve më të forta me klientët. Ndërsa nuk e dimë se sa do të vazhdojë kjo pandemi, BKT do vazhdojë të bëjë pjesën e saj, për të ndihmuar, ndër të tjera, mbështetur rinisjen e bizneseve dhe monitoruar me kujdes ecurinë e huamarrësve të saj, por edhe marrjen sa më shpejt të çdo mase të nevojshme, për të mos lejuar që sfida aktuale të transformohet te ato në vështirësi financiare afatgjatë dhe paaftësi paguese.

Realiteti i ri ka ri formatuar edhe mënyrën e të bërit banking, si dhe ka përshpejtuar ritmin e transformimit digjital. Nga perspektiva e sistemit bankar, kriza COVID-19 ka efekte specifike për administrimin dhe zbutjen e rrezikut të huas. Gjatë muajve të fundit, bankat janë përshtatur me dinamikën e re, ndërkohë karakteristikat unike të recesionit i kanë detyruar të lëvizin më shpejt, për bërë analiza në kohë sa më reale, sa i përket vendimmarrjes për hua. Fatmirësisht, sektori bankar është i mirë kapitalizuar dhe ka likuiditet, por është shqetësuese që kërkesa për hua ka rënë, çfarë nënkupton se tregu është në panik dhe ka rënie të konsumit. Në këtë aktualitet, besueshmëria, apo aftësia paguese e klientëve ndryshon sipas sektorëve dhe nënsektorëve në një shkallë më të lartë sesa në recesionet e mëparshme. Industritë si shpërndarësit e artikujve ushqimorë ecën më mirë, duke u përballur edhe me

kërkesën në rritje të konsumatorit. Ndërkohë, sektorët si: udhëtimi, transporti, turizmi dhe hotelet, baret dhe restorantet, janë sfiduar rëndë. Prandaj, për të vlerësuar aftësinë ri paguese të huas në kontekstin e kësaj krize, në linjë me ashpërsinë e ndikimit në sektorë e nënsektorë të ndryshëm të ekonomisë, çdo huamarrës vlerësohet individualisht, duke aplikuar dhe kombinuar teknika e skema të ndryshme të zbutjes së rrezikut të huas. Në këtë kontekst, banka ka azhornuar edhe oreksin për rrezikun e huas dhe ka riorientuar politikat e huadhënies, duke i bërë më të kujdesshme kriteret, por gjithmonë duke mos harruar kontributin e saj aq të nevojshëm në ri vitalizimin e ekonomisë.

Mësimi më i rëndësishëm nga pandemia COVID-19 është rëndësia e të punuarit së bashku për problemet që prekin të gjithë njerëzimin. Zgjedhjet e detyruara në kohë krize mund të ri formatojnë botën për dekada në vijim. Sikurse u tha më sipër, kjo krizë përshpejtoi ritmin e transformimit digjital, i cili tashmë është në proces të pakthyeshëm dhe qasja konsumatore, e ndikuar nga stili ynë i ri i jetës, po ri formatohet në këtë drejtim. Tashmë, sikurse edhe orientuar, më shumë veprime kanë filluar dhe bëhen nëpërmjet kanaleve online dhe bankingu tradicional do vijë duke u reduktuar, mbase duke shërbyer kështu edhe si një katalizator i zhvillimeve novatore bankare, aq të nevojshme dhe të domosdoshme për vendin tonë.

PAKETA E BIZNESIT ☰

ÇDO DITË
PRANË TEJ!

Credins Bank partneri yt
në çdo shërbim.

 **CREDINS** bank

www.bankcredins.com
Tel.: +355 4 53 53 000



Legjislacioni i ri për tregun e kapitaleve – një investim i rëndësishëm për zhvillimin dhe thellimin e sistemit financiar shqiptar

Aplikimi pjesor i MIFID II në Shqipëri, jo vetëm që është i përshtatshëm, por ndihmon në të njëjtën kohë edhe në zhvillimin e këtij tregu, duke vendosur standarde më të larta, me synim rritjen e besueshmërisë së investuesit në këtë treg.



Niko KOTONIKA

Drejtor, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimeve
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Ligji i ri nr. 62/2020 “Për Tregun e Kapitaleve”, që hyri në fuqi në 1 shtator 2020, synon të kontribuojë në thellimin e sektorit financiar, duke synuar në tërësi zhvillimin e tregut të kapitaleve, por në të njëjtën kohë, duke e lidhur këtë zhvillim me transparencën, integritetin e tregut dhe mbrojtjen e investuesit. Ligji është harmonizuar pjesërisht me një sërë direktivash të Bashkimit Evropian, kryesisht me direktivën e Tregjeve në Instrumente Financiare II (MIFID II), e cila standardizon sjelljen e aktorëve pjesëmarrës në tregjet e kapitalit.

Po sa i përshtatshëm është aplikimi i MIFID për një vend si Shqipëria, ku tregu i kapitaleve është në fazat e para të tij?

Të kuptuarit e tregjeve të kapitalit

dhe tregjeve financiare në tërësi lidhet ngushtë me rëndësinë që ka besueshmëria e investuesit në tregjet financiare, faktor ky tepër i rëndësishëm për zhvillimin e një tregu të ri kapitalesh, siç është rasti i Shqipërisë. Besueshmëria është një faktor, i cili është shumë i vështirë të ndërtohet. Abuzimet me tregun, mungesa e transparencës, si dhe dështimet e tregjeve në përgjithësi, ndikojnë në rënien e besueshmërisë.



Ligji i ri për tregun e kapitaleve është një parakusht dhe faktor nxitës për një treg kapitali transparent, të mirë rregulluar dhe të besueshëm, megjithatë zhvillimi i këtij tregu do të varet edhe nga një sërë faktorësh të tjerë si: zgjerimi i bazës investuese, përmirësimi i infrastrukturës së tregut, larmia e instrumenteve financiare, përputhja e kërkesës dhe ofertës për tituj, edukimi financiar i investuesit dhe emetuesit, apo dhe nxitja e shoqërive për t'u listuar në bursë me ofertë publike.



Nëse besueshmëria do të ishte në nivele të ulëta, atëherë do të ishte i pamundur krijimi i tregjeve të kapitalit, pasi investuesit nuk do të investonin në

produktet e investimit/instrumentet financiare, që ofron tregu i kapitalit.

Për këtë arsye aplikimi pjesor i MIFID II në Shqipëri, jo vetëm që është i përshtatshëm, por ndihmon në të njëjtën kohë edhe në zhvillimin e këtij tregu, duke vendosur standarde më të larta, me synim rritjen e besueshmërisë së investuesit në këtë treg. Ligji i ri, që ka në themel të tij mbrojtjen e investuesit i kategorizon investuesit në palë të pranueshme, investues profesionistë, investues jo profesionistë, dhe investues të kualifikuar. Qëllimi i kësaj ndarje është kryesisht për t'u siguruar që investuesit jo profesionistë të marrin nivelin e duhur të mbrojtjes, lidhur me aftësinë dhe dëshirën e tyre për të marrë përsipër rrezik, si dhe për të vendosur kërkesa të veçanta, në lidhje me transparencën që duhet të kenë shoqëritë komisionere, kur ofrojnë instrumente financiare ndaj këtyre investuesve. Ligji parashikon kërkesa për të gjitha shoqëritë komisionere që të kryejnë testin e përshtatshmërisë së investuesit, duke parashikuar gjithashtu edhe sanksione për të gjitha shoqëritë që nuk e kryejnë këtë test. Nëpërmjet testit të përshtatshmërisë shoqëria komisionere siguron informacionin e duhur rreth njohurive apo, eksperiencës së investuesit në tregjet financiare, situatës së tyre financiare, aftësinë për të përballuar humbjet, si dhe objektivave të investimit të tyre dhe tolerancës ndaj rrezikut. Në këtë mënyrë, investimi kryhet në përputhje me profilin e investuesit.

Një element shumë i rëndësishëm

në mirëfungsionimin e tregut të kapitaleve është dhe qeverisja e korporatave dhe kërkesat për një auditim cilësor të shoqërive të listuara. Skandali i fundit i Wirecard vërtetoi se sa e rëndësishme është cilësia e auditimit për shoqëritë e listuara, të cilat konsiderohen me interes të lartë publik. Kështu, ligji i ri për tregun e kapitalit vendos kritere specifike, lidhur me transparencën e shoqërive të listuara, si dhe kërkesa të veçanta për dhënien dhe publikimin e informacionit. Ky ligj parashikon edhe kritere në lidhje me audituesit e pasqyrave financiare të këtyre shoqërive.

Shpesh here direktiva MIFID kritikohet se vendos kërkesa të larta të qeverisjes së korporatave, si dhe kërkesa të reja në lidhje me organizimin e shoqërive komisionere, duke rritur në mënyrë të tërthortë kostot e shoqërive që operojnë në treg. Legjislacioni i ri në fushën e tregut të kapitaleve është hartuar me synim përafrimin e kërkesave për qeverisje dhe organizim të shoqërive komisionere me standardet evropiane, por duke iu përshtatur njëkohësisht edhe stadi aktual, në të cilin ndodhet zhvillimi i tregut të kapitaleve në Shqipëri. Në funksion të mirëfungsionimit të tregut të kapitaleve në vend, legjislacioni i ri parashikon standarde të larta, në përzgjedhjen e personave dhe funksionarëve kyç, të cilët do të kenë rolin kryesor në administrimin e veprimtarisë së këtyre shoqërive, si dhe një model krejt të ri të certifikimit të personelit kyç, në përputhje me standardet evropiane, duke i dhënë mundësi shoqërive më të vogla të delegojnë disa funksione. Në këtë mënyrë synohet njëkohësisht tërheqja dhe aktivizimi në tregun e kapitaleve i shoqërive komisionere serioze, të cilat kanë plane dhe ide të qarta biznesi, e që kanë njëkohësisht staf të kualifikuar, me aftësitë dhe përvojën e duhur profesionale për të operuar në një treg, në të cilin pjesëmarrja e lojtarëve me eksperiencë është e domosdoshme

për të nxitur zhvillimin e mëtejshëm të tij.

Me qëllim nxitjen e zhvillimit të tregut të kapitaleve, ligji i ri "Për Tregjet e Kapitalit" parashikon kërkesa të veçanta për licencimin e bankave, kur këto të fundit ofrojnë shërbime investimesh, duke synuar një proces më pak burokratik. Tregu financiar në Shqipëri dominohet kryesisht nga sektori bankar, i cili deri tani ka treguar nivele të larta të përgjegjshmërisë profesionale. Bankat luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të investimeve jo vetëm në Shqipëri, por thuajse në të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Parë nga një tjetër këndvështrim, sot, kur flitet për tregje kapitali, bëhet fjalë për tregje të integruara dhe globale. Investuesit sot mund të tregtojnë lirisht aty ku dëshirojnë dhe harmonizimi i legjislacionit me vendet më të zhvilluara, ndihmon në rritjen e mbrojtjes së këtyre investuesve. Ligji parashikon kërkesa të veçanta në lidhje me shoqëritë e huaja, të cilat mund të ofrojnë shërbimet e investimit në Shqipëri, nëpërmjet vendosjes së një zyre përfaqësimi, ose nëpërmjet një agjenti të lidhur, por duke parashikuar në të njëjtën kohë kërkesa për shoqëritë komisionere shqiptare, të cilat do të vendosin të ofrojnë shërbime.

Përveç Bursës, si një institucion shumë i rëndësishëm i tregut, ligji i ri parashikon kërkesa dhe për forma dhe struktura të reja organizimi të tregjeve, si: platforma shumëpalëshe e tregtimit, apo platforma e organizuar e tregtimit. Autoriteti aktualisht ka licencuar bursën shqiptare të titujve - ALSE, në të cilën tregtohen për momentin vetëm tituj të qeverisë. Listimi i shoqërive të para me ofertë publike mbetet një sfidë shumë e rëndësishme për zhvillimin e tregut të kapitaleve. Autoriteti është duke punuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet një grupi pune të përbashkët, për të analizuar mundësinë e transformimit të shoqërive me kapital shtetëror në

shoqëri me ofertë publike.

Oferta e titujve, drejtuar publikut rregullohet nëpërmjet një kapitulli të veçantë, duke parashikuar, ndër të tjera, edhe detyrimin për të publikuar Prospektin, si dokumenti më i rëndësishëm, i cili shërben për të informuar investuesin në lidhje me karakteristikat e ofertës, si dhe rreziqet që shoqërojnë këtë ofertë, duke synuar transparencë maksimale me investuesin në mënyrë që ky i fundit të marrë një vendim të mirë informuar, kur vendos të investojë në produktet e tregjeve të kapitalit. Akt-oferta është një dokument tjetër, i ngjashëm me prospektin, por i paraqitur në mënyrë më të thjeshtëzuar i përshtatur, kryesisht për investuesit profesionistë, apo individëve brenda një numri të kufizuar, në mënyrë që të thjeshtëzojë procesin e emetimit dhe në të njëjtën kohë të mbajë standarde të larta të transparencës.

Ligji i ka dhënë Autoritetit fuqinë e mjaftueshme për të siguruar një zbatueshmëri efektive të tij. Kështu, ky ligj mundëson rritjen e kompetencave të Autoritetit, në drejtim të kryerjes së hetimeve administrative në funksion të parandalimit të abuzimit me tregun, si dhe për të vendosur sanksione mbi të gjitha subjektet, që janë në shkelje të kërkesave ligjore.

Ligji i ri për tregun e kapitaleve është një parakusht dhe faktor nxitës për një treg kapitali transparent, të mirë rregulluar dhe të besueshëm, megjithatë zhvillimi i këtij tregu do të varet edhe nga një sërë faktorësh të tjerë si: zgjerimi i bazës investuese, përmirësimi i infrastrukturës së tregut, larmia e instrumenteve financiare, përputhja e kërkesës dhe ofertës për tituj, edukimi financiar i investuesit dhe emetuesit, apo dhe nxitja e shoqërive për t'u listuar në bursë me ofertë publike. Të gjithë këto faktorë lidhen ngushtë me vet rolin që duhet të luajnë aktorët kryesorë të tregut të kapitaleve në promovimin dhe zhvillimin e këtij tregu.

Drejt mentalitetit të përparësisë digjitale

Në nivel global, VISA ka ndërmarrë një sërë nismash, që synojnë të ndihmojnë bizneset për të realizuar transformimin digjital dhe motivimin e konsumatorëve në të gjithë botën, për të blerë pranë bizneseve vendase.



Vladimir DJORDJEVIC
DREJTOR I PËRGJITHSHËM,
SEE, VISA

Pandemia ka shkaktuar një nga tkurrjet më të mëdha ekonomike gjatë historisë së kohëve të fundit, duke e goditur jetën tonë nga të gjitha drejtimet. Ajo ka ndryshuar mënyrën se si punojmë, bashkëveprojmë me familjet tona, kolegët, partnerët e biznesit dhe komunitetet. Ndërkohë që shumë vende vendosën mbylljen e jetës sociale dhe ekonomisë, mbylljen e kufijve, ndalimin e tubimeve të çdo lloji dhe mbajtjen e distancës sociale, për të ndaluar përhapjen e koronavirusit, bizneset dhe konsumatorët në të gjithë globin nxitën rritjen e shpejtë të përdorimit të zgjidhjeve digjitale të pagesave, për të përmbushur nevojat e tyre.

Të dhënat tona tregojnë se, gjatë pandemisë, blerësit në të gjithë botën ishin në kërkim të një përvoje pagese më të sigurt e më të besueshme pranë POS-eve, duke zgjedhur shpesh opsionin e

zgjidhjeve pa kontakt fizik njerëzor (tap-to-pay). Në prill, mbi 70% e të gjitha pagesave VISA në të gjithë Evropën ishin pa kontakt. Në shumë nga vendet më të mëdha evropiane, pjesa e transaksioneve VISA që kryhen pa kontakt është rritur me të paktën 25%, me bazë vjetore. Kjo i ka ndihmuar konsumatorët të bëjnë blerje në vlera më të mëdha, si p.sh.: ushqime, pa kontakt me терминаlet e pagesave. Në Shqipëri, numri i transaksioneve pa kontakt tregon një prirje rritëse gjatë pandemisë COVID-19 dhe në qershor numri i transaksioneve u rrit 87%, krahasuar me marsin kur filloi pandemia.

Në kushtet kur blerësit kalojnë më shumë kohë në shtëpitë e tyre dhe tregtarët që i transferojnë shitjet në fushën digjitale, tregtia elektronike në të gjithë botën do të vijojë të rritet. Në Mbretërinë e Bashkuar, përdoruesit aktivë të tregtisë elektronike u rritën me 16%, ndërsa shpenzimet për përdorues aktiv u rritën me 3%. Në anën tjetër të botës, në Brazil, përdoruesit aktiv të tregtisë elektronike u rritën me 11% dhe shpenzimet për përdorues aktiv u rritën me 12%. Në tregjet ku tregtia elektronike nuk është aq e zhvilluar, ka shembuj të ndryshimeve dramatike. Argjentina përjetoi rritje aktive të kartave të tregtisë elektronike me mbi 100% dhe Rumania me 70%. Në Shqipëri, tregtia elektronike në blerjet brenda vendit ishte kontribuuesi kryesor i rritjes me një normë prej +500-600% në vit, në prill dhe në maj. Ushqimet ishin segmenti më i madh i tregut në tregtinë e brendshme, me normën më të

lartë të rritjes, gjatë periudhës së COVID-19 – deri në 60% krahasuar me vitin e kaluar.

Ofrimi i përvojës së pagesave të vazhdueshme për të gjitha palët

Në kushtet kur pandemia shërbeu si një katalizator për kalimin drejt pagesave digjitale, angazhimi afatgjatë i VISA-s, për të siguruar një përvojë më të sigurt e komode pagese për të gjithë dhe për ta bërë tregtinë digjitale të disponueshme për më shumë individë, biznese të vogla dhe mikro, është bërë më i rëndësishëm se kurrë. Për të ndihmuar në përmbushjen e kërkesës në rritje për pagesa digjitale të sigurta dhe të besueshme, VISA ka bashkëpunuar me qeveritë, në më shumë se 55 vende në botë, për të rritur kufijtë e përdorimit të kartave pa kontakt, në mënyrë që konsumatorët të mund të paguajnë pa prekur терминаlet, ose ndonjë person tjetër, e si rrjedhojë, të ndihen më të sigurt në arkë. Në rajonin e Evropës Juglindore VISA rriti kufirin për transaksionet pa kontakt, që nuk kërkojnë kodin PIN për konfirmim, duke mundësuar konsumatorët të kryejnë pagesa pa prekur терминаlet, duke përdorur kartat pa kontakt. Në Shqipëri, kufiri u rrit në 5.500 lekë, ose 22% më shumë se niveli i mëparshëm.

Për më tepër, VISA ka mbi 60 vjet rresht që ofron zgjidhjet më të besueshme dhe më të sigurta për pagesa, për tregtarët dhe konsumatorët e tyre. Në fillim të këtij viti, VISA prezantoi **Visa Secure** (e njohur më parë si **Verified by Visa**), për të siguruar një mbrojtje të shtuar ndaj

NDRYSHIMI I ZAKONEVE DHE SJELLJVE

Pandemia detyroi shumë përfaqësues të biznesit dhe konsumatorë, anembanë botës, të adoptojnë sjellje të reja, për të zgjidhur krizat me të cilat po përballen. Me qëllim që të kuptohej më mirë ndikimi i e sëmundjes së koronavirusit dhe për të ofruar zgjidhje domethënëse për NMV-të, VISA kreu një Studim në rrafsh global: "Kthimi në Punë", duke intervistuar 4,500 konsumatorë dhe 2,000 pronarë biznesesh të vogla në Brazil, Kanada, Gjermani, Hong Kong, Irlandë, Singapor, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe SH.B.A. Sipas këtij studimi, rreth 8 në 10 konsumatorë në gjithë botën (78%) kanë ndryshuar mënyrën e pagesës, me synim zvogëlimin e kontakteve dhe më shumë se dy të tretat e NMV-ve (67%) kanë provuar një qasje të re – qoftë duke hapur një faqe për tregti elektronike, ose duke ndryshuar teknologjinë e POS-eve – për të mbajtur biznesin në punë. Tani, më shumë se kurrë, konsumatorët presin një përvojë pagese të sigurt dhe pa kontakt, në POS-e. Thuajse gjysma e tyre (48%) nuk do të blinin në një dyqan që ofron vetëm mënyra pagese që kërkojnë kontakt me një arkëtar, ose makinë, si: lexuesi i kartave. Nga ana tjetër, pronarët e bizneseve të vogla po përqendrohen në kalimin drejt mentalitetit të përparësisë digjitale, ku më shumë se një e katërta (28%) kanë provuar reklama të synuara në mediat sociale, ose kanë shitur produkte ose shërbime në internet (27%).

Me formësimin e normales së re rreth asaj se çfarë, ku dhe si blejmë, shqiptarët gjithashtu po tregojnë interes më të madh për zgjidhjet e pagesave digjitale. Një studim rajonal, i kryer brenda fushatës "Krah për krah me të ardhmen digjitale" zbuloi se më shumë se 40 përqind e të anketuarve në Shqipëri janë të gatshëm të kryejnë transaksione pa kontakt, pasi u sjell atyre përfitime të shumta. Një në 10 konsumatorë të intervistuar në Shqipëri përdor metodën pa kontakt (tap-to-pay) dhe është i motivuar që ta njohë këtë teknologji edhe më mirë. Rreth 60% e të anketuarve në Shqipëri blejnë mallra dhe shërbime nga interneti, duke theksuar efektivitetin e kohës dhe kostos, sigurinë dhe komoditetin, si arsye kryesore për blerjet në internet.

mashttrimit, duke minimizuar problemet e kartëmbajtësve dhe për të rritur ekzekutimin e shitjeve, duke siguruar një përvojë më të mirë, si për tregtarët ashtu dhe për blerësit. **Visa Secure** përdor specifikimin më të fundit EMV 3-D Secure (3DS), që është protokoll i ri i mesazheve në të gjithë industrinë, i zhvilluar për të promovuar verifikimin e lehtë të konsumatorit. Kjo u mundëson konsumatorëve të verifikojnë identitetin e tyre me bankën emetuese, ose subjektin tjetër (emetuesin) kur kryejnë pagesa elektronike/pagesa pa praninë e kartës (CNP). Masa shpesh e sigurisë ndihmon në parandalimin e transaksioneve CNP të paautorizuara dhe ndihmon në mbrojtjen e tregtarëve nga ekspozimi ndaj mashttimeve gjatë pagesave elektronike.

Rrugëtimi drejt normales së re

Sfidat e jashtëzakonshme ekonomike, të shkaktuara/sjella nga COVID-19, po godasin fort bizneset e vogla dhe mikro, që janë shtylla kurrizore e ekonomisë globale, e që përbëjnë më shumë se 90 përqind të bizneseve në të gjithë botën, kontribuojnë në më shumë se gjysmën e punësimit global dhe përfaqësojnë 60 përqind të PBB-së, në vendet me të ardhura të ulëta. Në nivel global, VISA ka ndërmarrë një sërë nismash, që synojnë të ndihmojnë bizneset për të realizuar transformimin digjital dhe motivimin e konsumatorëve në të gjithë botën, për të blerë pranë bizneseve vendase.

Në Shqipëri, VISA bashkëpunoi me bankat për të mbështetur rritjen e tregtisë elektronike, duke shpërblyer klientët me 5%

kthim të parave. Një fushatë tjetër nisi këtë vit, që u përqendrua në pagesat pa kontakt, duke synuar të motivojë qytetarët të bëhen mbajtës të kartave pa kontakt dhe të ndikojë në përdorimin e tyre nga përdoruesit ekzistues. Ndërsa interesi për blerjet nëpërmjet tregtisë elektronike u rrit gjatë pandemisë, VISA promovoi disa video këshilluese, me synim edukimin e përdoruesve se si të blejnë në internet, e të mbrohen nga vjedhja e të dhënave.

Ndërsa bota dalëngadalë po del nga mbyllja, duke zbutur masat e distancimit social dhe duke u rihapur për biznes, VISA mbetet e përkushtuar për të ndihmuar botën të rimëkëmbet nga shkatërrimi ekonomik dhe t'i përshtatet rrugëtimit drejt botës digjitale, duke përdorur aktivitetet e saj për t'i rikthyer të gjithë në punë.

Renminbi digjital - një pashmangshmëri teknike



Dr. Genti BEQIRI

Lektor
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, UET

Krahasuar me historinë e parasë dhe bankave tregtare, historia e bankave qendrore është shumë më e shkurtër dhe e ndikuar përherë nga zhvillimi i shteteve moderne, nga mjedisi ekonomik dhe nga përparimet teknologjike. Për këtë arsye, risitë e vazhdueshme të teknologjisë dhe globalizimi pritet që, në të ardhmen e afërt, të kenë ndikime të rëndësishme te bankat qendrore. Meqenëse të gjitha veprimtaritë thelbësore të bankave qendrore, siç janë: emetimi i parasë, funksionimi i sistemeve të pagesave, roli i tyre si huadhënës i fundit dhe hartuese e zbatuese e politikës monetare, bazohen te "besimi".

Historia e tyre ka qenë, dhe e ardhmja gjithashtu, e lidhur ngushtë me kornizën efikase të ndërtimit të besimit dhe pasqyrimin të kushteve të reja teknologjike dhe institucionale. Edhe pse inovacioni digjital mund të ndikojë në qasjen e veprimtarisë së bankave qendrore në të ardhmen, rëndësia dhe efektiviteti i funksionit të pagesave dhe infrastrukturës së tyre, funksioneve të tjera dhe politikave të tyre monetare do të ruhen. Për më

tepër, nevoja për para' pa rrezik nga banka qendrore do të mbetet e fortë, për shkak të aftësisë së saj për të zvogëluar rreziqet në transaksionet ekonomike. Bankat qendrore do të duhet të vazhdojnë të bëjnë përpjekje për të përmbushur këto kërkesa, përmes përmirësimit të shërbimeve dhe infrastrukturës së tyre, duke përfshirë sistemet e pagesave në kohë reale. E ardhmja e bankave qendrore dhe digjitalizimit të tyre të mëtejshëm është e ndërlidhur ngushtë me atë të shteteve dhe vendit ku ato operojnë dhe varet nga aftësia e saj për të identifikuar mënyrën ideale të përdorimit të informacionit dhe të dhënave në ekonomi.

Gjatë kësaj periudhe të pandemisë globale bankat qendrore kanë pasur një periudhë shumë të ngarkuar. Së bashku me injektimin e shumave të mëdha të parave në sistemin financiar, ato kanë pastruar gjithashtu shumën të jashtëzakonshme parash. Nga Amerika në Korenë e Jugut, bankat qendrore kanë karantinuar dhe dezinfektuar kartëmonedha potencialisht të ndotura. Gjithashtu, shumë vende kanë aplikuar politika të forta nxitëse dhe ndihme financiare për familjet e bizneset, e për këtë arsye qeveritë dhe bankat qendrore janë gjithnjë e më të interesuara për një sistem të monedhës digjitale. Për më tepër, mënyra se si paguajmë për mallrat dhe shërbimet, po ndryshon shumë shpejt. Duopoli i kartave të pagesave VISA dhe MasterCard po rrit në mënyrë të vazhdueshme shtrirjen e tyre në shumë pjesë të botës. Në të njëjtën kohë, kompanitë e teknologjisë, si: Apple, Ant Financial në Kinë, Swish në Suedi dhe M-Pesa në Kenia po ndryshojnë me shpejtësi lojën për pagesa nëpërmjet telefonit celular. Gjithashtu, Facebook ka plane ambicioze në lidhje me këtë, por hasi menjëherë në një mur rezistence nga

institucionet politikëbërëse në SHBA dhe në shumë vende të zhvilluara.

Duket se shprehja "paraja (cash) është mbret" po humbet përherë e më shumë rëndësinë dhe kuptimin. Ndërsa teknologjia përparon, shumë vende po shqyrtojnë me vëmendje zhvillimet dhe mënyrën se si do të përshtaten me këtë realitet të ri, në sistemin e pagesave dhe atë bankar. Nevoja për kontroll të vazhdueshëm e të shpejtë e bën akoma më të rëndësishme këtë çështje.

Që nga fundi i viteve 2000, Kina është përpjekur të përshpejtojë ndërkombëtarizimin e monedhës së saj Renminbi - RMB, me masa politike, ndërhyrje financiare, siç janë p.sh.: obligacionet *Dim Sum Bond*, por edhe me forma të tjera. "Dim Sum Bond" është një term i përdorur për obligacionet e emetuara në RMB kinez dhe të tregtuara në Hong - Kong. Obligacionet janë tërheqëse për investuesit e huaj që dëshirojnë të blejnë aktive në monedhën RMB, por që janë të kufizuara prej kontrollit të kapitalit brenda Kinës, për të investuar në borxhin e brendshëm të tyre. Blerja dhe tregtimi i tyre në Hong - Kong, apo Macau, është një "dritare" e lënë hapur, për të anashkaluar këtë kufizim ligjor të hasur brenda kufijve administrative të Kinës. Obligacionet kanë qënë tërheqëse për kapitalin dhe ekonomitë e Azisë Juglindore, të njohura si ASEAN, por edhe ato amerikane, si p.sh.: McDonald, që është e shtrirë mirë në Kinë. Sidoqoftë, këto mund të shihen si pararendëse të hapave të ardhshëm të lëvizjeve, që shteti kinez po përgatitet të ndërmarrë: pozicionimi i RMB si një monedhë *reserve premium* për botën, ashtu si USD, apo Euro dhe mënyra më e mirë dhe e shpejtë do të ishte monedha digjitale.

Ndërsa paratë fizike nuk janë ende të rrezikuara në shumicën e

Aplikacioni
FIBANK MOBILE



**Banka në
dorën tënde**

- **Transferta**
 - **Kredi**
 - **Karta**
 - **Fatura Utilitare**
- & shumë shërbime të tjera!

Shkarko në:



Fibank
First Investment Bank

ekonomive të zhvilluara botërore, përvoja e disa vendeve, veçanërisht e Suedisë, Kinës, Koresë së Jugut, Holandës e madje në një farë mase edhe Mbretërisë së Bashkuar, tregon një botë me përdorim përherë e më pak të parave të gatshme (*cash*), e kjo është gjithnjë e më e mundur. Kjo është arsyeja pse shumë analistë kanë trajtuar mënyrat e mundshme të tregtimit për një monedhë digjitale, të mbështetur nga bankat qendrore respektive.

Kina filloi të eksplorojë konceptin e digjitalizimit që në vitin 2014, për shkak të trazirave teknologjike të sistemit të saj financiar. Një dhjetëvjeçar më parë mbizotëronte paraja e gatshme; vitin e kaluar transaksionet monetare arritën në 347 trilion *Yuan* (US\$ 49 trilionë), duke zënë katër transaksione për çdo pesë pagesa. Një monedhë zyrtare digjitale mund të ndihmojë në menaxhimin e një rreziku nga ky vëllim i madh në këtë periudhë zhvillimi e tranzicioni. Në rast të një dështimi të sistemeve të pagesave, ose një krizë si pandemia Covid-19 të shpërthejë akoma me gjatë, njerëzit mund të duan para, por do të ketë gjithnjë e më pak në qarkullim.

Kina ka kohë që po vijon me planet e saj për të emetuar një RMB digjital, me qëllim që të bëhet vendi i parë në botë që ofron një monedhë sovraane digjitale. Pas fillimit të testeve të monedhës digjitale të Bankës Qendrore të Monedhave Digjitale, ose CBDC, në katër qytete kineze — Shenzhen, Suzhou, Chengdu dhe Xiong'an — në maj 2020, Banka Qendrore e Kinës - Banka Popullore e Kinës, tani është në diskutime me kompani private, për të zgjeruar testin e saj më tej. Firma të mëdha si: Didi Chuxing, kompania më e madhe e udhëtimeve në Kinë dhe gjigandi i shpërndarjes së ushqimeve Meituan Dianping janë mes kandidatëve për të mbështetur një RMB digjital në një shkallë të gjerë, përmes platformave

të tyre tejet të mëdha. Kjo afërmendsh do tu jepte atyre shumë shpejtësi në tregti.

Testimi i plotë i monedhës digjitale është shumë i rëndësishëm për ekonominë kineze, sepse stabiliteti financiar është nën trysni dhe diskutim të vazhdueshëm. Pandemia nxori në pah edhe më shumë dobësitë e sistemit bankar standard. Sipas kompanive *Fintech* në rajon, ky është një hap i fortë drejt inovacionit, pasi është hera e parë që do të kemi para që programohen për t'i bërë gjërat automatikisht; kjo ka funksionalitet dhe mbështetjen e plotë në këtë periudhë ekonomike. Monedha kombëtare digjitale është bërë, siç kanë thënë vet në Kinë, një pashmangshmëri teknike. Kjo nuk ka të bëjë me atë nëse ata duhet të fillojnë me këtë sipërmarrje; ajo është një domosdoshmëri absolute për t'u zhvilluar më tej. Kjo ka vërtet kuptim, sepse mjafton të shikoni jetën tonë: ne gjithnjë e më shumë e jetojmë jetën në rrjet... në internet. Ne kemi jetë të lidhur shumë ngushtë me teknologjinë dhe po shkojmë drejt një ekonomie digjitale; një ekonomi digjitale e cila përfshin edhe paranë përfaqësuese (tokenization). Ekonomia e re digjitale ka nevojë për para digjitale dhe shumë vende e kanë kuptuar këtë. Ajo ka nevojë për para përfaqësuese (*fiat*) në një format digjital. Përndryshe, ekonomitë, e në mënyrë të veçantë ajo kineze, do të jenë nën kërcënimin e monedhave Bitcoin, Ethereum, ose Ripple, apo monedhave të tjera, që kanë teknologjinë e duhur për t'u integruar në ekonominë e re digjitale pa shumë vështirësi. Pra, është një domosdoshmëri absolute që Banka qendrore e Kinës, si dhe çdo bankë tjetër qendrore, të përmirësojnë monedhën e saj. Çështjet e vërteta në këtë histori janë dy: E para çështja e privatësisë dhe e dyta nëse vërtet Kina mund ta kthejë monedhën e saj digjitale në një monedhë rezervë, si dollari amerikan.

Për sa i përket çështjes së privatësisë, të dhënat që do të mbledhë banka qendrore, ajo ka dy anë. Nga njëra anë, të dhënat do të përfshijnë veprimtarinë e plotë ekonomike të një vendi në kohë reale, pasi të dhënat do të regjistrohen në regjistra të shpërndarë (*blockchain*). Kështu, qeveria do të ketë qasje në të gjitha këto, në kohë reale. Nga ana tjetër, kjo do t'i mundësojë bankës qendrore të kryejë punën e saj në mënyrë më efektive, sepse në vend që të kenë një vonesë në të dhënat ekonomike, banka qendrore është në gjendje të monitorojë të gjitha shpenzimet, transaksionet, ofertën e parasë, pasojat e inflacionit, në kohë reale. Për më tepër, ajo do të jetë e aftë të gjurmtojë se ku shkojnë njerëzit në botë, sepse Banka Qendrore e Monedhës Digjitale do të jetë në dispozicion të kinezëve edhe kur ata bëjnë biznes, apo paguajnë në vendet e tjera. Në fakt është pothuaj një lloj mënyre për të gjurmuar një individ. Pra, ka pyetje të mëdha alarmante që duhet të merren parasysh siç duhet kur bëhet fjalë për privatësinë dhe anonimat.

E dyta, nëse Kina dëshiron që monedha e saj të rrjedhë lirisht jashtë kufijve të saj, ajo ka aftësinë teknologjike për ta bërë realitet. Këtë e mbështet fluksi i jashtëzakonshëm i tregtisë, që vjen si pasojë e nismës: *Një rrugë, një brez (Belt and Road Initiative)*, por edhe të tjera si këto. Dollari amerikan është ende monedha që duhet të këmbëhet dhe transaksionet më të mëdha duhet të rrjedhin përmes dollarit amerikan. Pra, ekziston një rast që monedha e re digjitale të bëhet një instrument i pagesave universale për vendet që janë pjesë e nismave tregtare me Kinën, e atëherë ajo mund të ngrihet në rolin e një monedhe rezervë në botë, për vendet Aziatike fillimisht, e më pas atyre në zhvillim, në mbarë botën. E gjitha kjo mbetet për tu parë e përjetuar....!

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE E KORPORATËS



- Për të dytin vit radhazi banka ishte një nga mbështetësit e programit "Tungjatjeta Jetë" të World Vision Albania, një program social që ofron shërbime të specializuara për 72 fëmijë me aftësi ndryshe në fshatra të Librazhdit, Përrenjasit, Dibrës e Bulqizës.
- Mundësoi kompjutera për laboratorët e informatikës së gjashtë 6 shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në qytetin e Peshkopisë.
- Kontribuoi me blerjen e një sasive të konsiderueshme raftesh dhe tezgash, për të ndihmuar shitësit sezonal të qytetit Pogradec në tregtimin e produkteve bujqësore, blegtorale dhe artistike.
- Mundësoi organizimin e ekspozitës "Gjurmë çastesh – Duke ëndërruar vazhdimësinë" në bashkëpunim me Gallery70.



- Mbështeti organizatën "Të Ndryshëm & Të Barabartë"- Strehëzën për Riintegrimin e Viktimave të Trafikimit dhe Qendrat e Përkujdesjes Ditore për fëmijët e tyre, në Tiranë dhe Shkodër, për përmirësimin e mjediseve fizike.
- Në vijim të përpjekjeve për të zbutur situatën e krijuar nga Covid-19, banka i është përgjigjur kërkesës së Bashkisë Selenicë, për dhurimin e 100 paketave ushqimore në ndihmë të familjeve në vështirësi ekonomike në këtë bashki, si edhe në njësitë administrative Kotë dhe Armen.



- Mbështeti spitalin "Shefqet Ndroqi", duke dhuruar pajisje spitalore Echo Portable.
- Në prag të nisjes së vitit të ri shkollor 2020-2021, dhuroi maska dhe dezinfektantë, për disa prej shkollave të Tiranës.
- Mbështeti Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë, duke mbuluar shpenzimet për blerjen e dezinfektantëve, maskave dhe dorezave për punonjësit e këtij institucioni.
- Banka së bashku me gjithë stafin e saj ka mbështetur fëmijët e Fshatit "SOS" me mjete didaktike dhe shkollore.
- Dhuroi pajisje kompjuterike dhe sisteme teknologjike për Bashkinë Kukës, Qendrën Shëndetësore Vorë dhe Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.
- Mbështet Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan në blerjen e materialeve për të përmirësimin e infrastrukturës.
- Mbështet I.E.V.P Durrës, A.SH.K Drejtoria Vendore Fier dhe Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, për të përmirësuar infrastrukturën dhe kushtet e mjediseve të punës në institucion.
- Mbështeti Innovation Investment Fund në organizimin e "Agro-Turizmi: Sektori primar për investim". Credins Bank është një aktor i rëndësishëm në mbështetje të fermerëve anëmbanë vendit, duke ofruar produkte dhe shërbime bankare, në përputhje me nevojat e tyre të rritjes dhe zhvillimit, si dhe duke ofruar këshillim bankar për të promovuar me tej agro-



turizmin në gjithë vendin.

- Mbështetjeprimtarinë: “Festa e Gjysheve”. Festa u mbajt në qytetin e Përmetit për 2 ditë, ku pati një larmi veprimtarish dhe performuesish.

otpbank

- Në datën 3 korrik, 2020, në mjediset e shkollës “Avni Rustemi” u shpërndanë 100 pako me ushqime për 100 familje (prindër të fëmijëve me aftësi ndryshe).
- Banka iu përgjigj thirrjes se OJF-ve në ndihme të një grupi familjesh në vështirësi ekonomike, ku njëri prej prindërve nuk jeton më dhe fëmijët janë minorenë, me statusin e jetimit, duke mundësuar shpërndarjen e ndihmave ushqimore për këta fëmijë.
- Banka akordoi një fond për rinovimin e zyrave qendrore të Kryqit të Kuq, Vlorë.
- Ndërmori fushatën ndërgjegjësuëse: “OTP rekomandon”, për promovimin e turizmit vendas.
- “Jeto Shqip” - Fushatë promovuese kushtuar konsumit të produkteve shqiptare, që synon të inkurajojë forcimin e ekonomisë vendase nëpërmjet konsumit të produkteve dhe shërbimeve shqiptare.
- Organizoi Konkursin për “Research Paper”, me pjesëmarrës studentë të Universiteteve Shqiptare. Duke iu përmbajtur temës “Ndikimi i COVID-19 në Shqipëri – Si do të operojnë bankat tani?”, studentë nga fusha të ndryshme, duke

bërë një kërkim të thelluar në treg, ofruan idetë e tyre për zgjidhje novatore në shërbimin bankar. Konkursi u kurorëzua me tre grupe fitues dhe iu dha mundësinë studentëve të bëhen pjesë e programit të praktikës në bankë, e njëkohësisht mundësinë për t’u bërë pjesë e stafit të saj.

- Në kuadër të përmirësimit të kushteve të punës në institucionet qeveritare dhe ato akademike, Banka OTP - Albania dhuroi pajisje kompjuterike dhe printera për një sërë entesh: Bashkia e Tiranës, Bashkia Devoll, Qendra Ekonomike Arsimore Durrës, Prefektura e Qarkut Vlorë dhe Universiteti Politeknik Tiranë.

Raiffeisen BANK

- Raiffeisen Bank u bashkua me përpjekjet e institucioneve shëndetësore për të përballuar situatën Covid-19 në Shqipëri, duke dhuruar një fond prej 40 mijë eurosh në ndihmë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në ceremoninë e dorëzimit të këtij donacioni Z. Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank – Albania përgëzoi Ministrinë e Shëndetësisë dhe veçanërisht të gjithë stafin mjekësor, për punën heroike në këto ditë të vështira.
- Falë mbështetjes së Raiffeisen Invest u bë e mundur pajisja e shkollës 9-vjeçare “Vrinë” në Sarandë me një terren të ri sportiv, pajisja e shkollës “Petro Nini Luarasi” në Ersekë me një laborator



DEPOZITA ME AFAT ME NORME INTERESI DERI 6 %



#GJITHMONEBASHKE

 **INTESA SANPAOLO BANK**
Albania

    www.intesasanpaolobank.al

CONTACT CENTER
08006000 (Falas nga Alltelecom) +355 4 2276000, +355 692080903

Bankë e **INTESA**  **SANPAOLO**

të ri informatike, pajisja e shkollës "31 Korriku" Mat me një bibliotekë të re, pajisja e shkollës "Bardhyl Pojani" në Korçë me pajisje të reja kompjuterike dhe pajisja e shkollës "Kryezi" me një sallë të re mbledhjesh. Gjithashtu, për t'ju ardhur në ndihmë në punën e tyre të përditshme, u mbështetën me pajisje kompjuterike dhe pajisje të ndryshme zyrash: Zyra Arsimore Shkodër, Zyra Vendore Arsimore Roskovec dhe ajo Tepelenë – Memaliaj.

- Për të 8-in vit me radhë Raiffeisen Bank mbështeti ICT Awards, ngjarjen më të rëndësishme kushtuar teknologjisë dhe komunikimit. Ky event u finalizua më datë 10 korrik me një mbrëmje gala, ku edhe u ndanë çmimet fituese në disa kategori.
- Mbështeti veprimtarinë "Fëmijët ndryshojnë botën", të organizuar nga qendra Gjenerata e Re.
- Mbështeti edicionin e 9-të "Jazz fest 2020", një festival i mirëfilltë i muzikës Jazz.

TIRANA BANK

- Në bashkëpunim me Bashkinë e Pogradecit kontribuoi në vendosjen e koshave pranë shëtitores së qytetit, nën moton "Së bashku për një qytet të pastër".
- Ndërtoi një shesh lojërash për fëmijët, në një nga zonat periferike të kryeqytetit. Parku prej 520 metra katrorë ndodhet në Sauk dhe është ndërtuar sipas një projekti të përbashkët me Bashkinë e Tiranës. Përveç shumë fëmijëve, Kryetari i Bashkisë

së Tiranës, Erion Veliaj dhe Z. Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm i Tirana Bank, ishin të pranishëm në ceremoninë e inaugurimit të këndit të lojërave. Përfundimi i parkut u shoqërua me një festë nga Cirku i Tiranës.

- Pajisi me kompjuterë agjencinë rajonale të mjedisit në qytetin e Fierit.
- Bashkëpunoi me Kryqin e Kuq dhe mundësoi blerjen e çantave dhe artikujve shkollor për fëmijët e familjeve në pamundësi financiare.

UNIONBANK

- Gjatë sezonit turistik të verës, Union Bank vendosi në dispozicion të pushuesve 100 çadra, në një nga plazhet publike të qytetit të Vlorës. Çadrat ishin të vlefshme për t'u përdorur nga çdo turist apo qytetar, pa pagesë. Në fund të sezonit turistik, kjo sasi çadrash iu dhurua Bashkisë Vlorë.
- Në mbështetje të situatës së vështirë të krijuar nga pandemia Covid-19, Union Bank që prej muajit gusht ka filluar ndihmën periodike për furnizimin e QSUT (Qendra Spitalore Nënë Tereza) me bateri për aparatet oksimetër që përdoren në trajtimin e pacientëve me Covid-19. Ky projekt është lidhur edhe me klientët e Union Bank, të cilët mund të ndihmojnë në rritjen e numrit të baterive të dhuruara, ku për çdo 4 transaksione të kryera në platformën e-banking UB Online, dhurohet një bateri.



TË REJA NGA SEKTORI BANKAR



Finance Central Europe në eventin: "Top South East Europe Bank Rankings 2020", në përvjetorin e saj të 21-të, vlerëson Drejtorin e Përgjithshëm të bankës Z. Seyhan Pencabliligil dhe Bankën Kombëtare Tregtare me çmimet:

- "Banka më e mirë në Shqipëri për vitin 2020"- Banka Kombëtare Tregtare Sh.A, Tiranë, Shqipëri
- "Banka më e mirë në Shqipëri për sa i përket qëndrueshmërisë së aktiveve për vitin 2020"- Banka Kombëtare Tregtare Sh.A, Tiranë, Shqipëri
- "Banka më e mirë në Shqipëri për sa i përket qëndrueshmërisë së kapitalit për vitin 2020"- Banka Kombëtare Tregtare Sh.A, Tiranë, Shqipëri
- "Banka më e mirë në Shqipëri për sa i përket Fitimit Para Tatimit për vitin 2020"- Banka Kombëtare Tregtare Sh.A, Tiranë, Shqipëri
- "Bankieri më i mirë në Shqipëri për vitin 2020" - Z. Seyhan Pencabliligil, CEO, Banka Kombëtare Tregtare Sh.A, Tiranë, Shqipëri



JCR Eurasia Rating, gjatë vlerësimeve periodike, ka konfirmuar për Bankën Kombëtare Tregtare Sh.A. një situatë "të qëndrueshme", respektivisht me një vlerësim **'AAA (Alb)'** në terma afatgjatë në kredi dhe me një vlerësim **A-1+ (Alb)'** situatën në terma afatshkurtër në kredi, Vlerësimet në terma afatgjatë për monedhën lokale dhe ato të huaja janë **'BB+',** duke pasqyruar kështu kufirin e vendit ku ndodhet aksionari kryesor, Turqia (BB+), dhe një notë më të lartë se vendi ku renditet Shqipëria (BB).

Për të vazhduar përpjekjet për zhvillimin e qëndrueshëm, BKT u bë pjesë e organizatës **United Nations Global Compact**, nismës më të madhe botërore për qëndrueshmërinë e korporatave. United Nations Global Compact është një organizatë ndërkombëtare që operon në gjithë botën, me qëllim mobilizimin e kompanive globale që të ndjekin dhe zbatojnë 10 Parimet mbi të drejtat e njeriut, punës, mjedisit dhe anti-korrupsionin. Duke qenë pjesë e United Nations Global Compact Banka Kombëtare Tregtare mbështet:

- Nismën e të bërit biznes me përgjegjësi, duke lidhur strategjitë dhe operacionet me parimet mbi të drejtat e njeriut, punës, mjedisit dhe anti-korrupsionin;
- Ndërmarrjen e veprimeve strategjike, për të mbështetur Zhvillimin e Qendrueshëm të shoqërisë, bashkëpunimit dhe inovacionit.



Z. Silvio Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe Intesa Sanaolo Bank Albania, janë nderuar me çmimet e mëposhtme nga revistat prestigjioze

ndërkombëtare në fushën e biznesit dhe financës:

Business Worldwide:

- CEO më i mirë në Industrinë Bankare në Shqipëri
- CEO më Inovativ i Vitit - Shqipëri



Çmimet e Revistës "International Business":

- CEO i Vitit në Industrinë Bankare për Shqipërinë
- Banka më e mirë për Shërbimet e Klientëve VIP - "Private Banking" në Shqipëri, 2020



Global Excellence Award

- Ofruesi më i Mirë i Shërbimeve Bankare & Financiare në Shqipëri - 2020



"Çmimet e Ekselencës" të Euromoney njihen si çmimet më të lakmuara dhe më të besueshme në industrinë bankare. Banka OTP - Albania u vlerësua nga Euromoney me çmimin "Banka më e mirë" në Shqipëri për vitin 2020.



AAB AKTIVITETE & TRAJNIME

Projektligji “Për amnistinë fiskale dhe penale, për subjektet që bëjnë deklarim vullnetar të pasurive”

Ministria e Financave & Ekonomisë zhvilloi takime të njëpasnjëshme me grupet e interesit, duke filluar zyrtarisht procesin e konsultimit publik mbi Projektligjin:

- Më 7 korrik, përfaqësuesit e AAB-së morën pjesë në takim online me përfaqësuesit e autoriteteve, ku u diskutua në parim projektligji dhe detajet teknike përkatëse.
- Më 15 dhe 16 korrik, Sekretariati i AAB-së paraqiti përkatësisht në Ministrinë e Financave & Ekonomisë dhe Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, komentet dhe sugjerimet e unifikuara të bankave anëtare mbi projektligjin.
- Më 24 korrik, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, së bashku me përfaqësuesit e bankave, morën pjesë në seancën dëgjimore të Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, lidhur me projektligjin.

Standardet e Përgjithshme të Raportimit (CRS)

Sekretariati i AAB-së ka pasur një komunikim institucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Ministrinë e Financave & Ekonomisë, për të trajtuar çështjet teknike të bankave, lidhur me standardet e përgjithshme të raportimit (CRS) dhe me ligjet e përgatitura për zbatimin e tij, e veçanërisht për zgjatjen e afatit të raportimit për institucionet financiare, deri më 15 nëntor 2020 (një propozim që u mor në konsideratë nga Ministria, duke ndryshuar ligjin “Për shkëmbimin automatik të informacionit”).

Projektligji “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”

Në 16 shtator, u organizua një takim konsultativ me përfaqësues të Ministrisë së Financave & Ekonomisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku diskutuan projektligji i ri.

Seminar me fokus mashtrimin në internet

Në datën 15 korrik 2020, Shoqata Shqiptare e Bankave, REAL Security dhe Group-IB organizuan një seminar informues dhe ndërveprues (interaktiv), mbi mashtrimin në internet.

Ekspertët kryesorë të industrisë ndanë mendimet e tyre mbi llojet kryesore të mashtrimit në internet dhe mënyrat e parandalimit në mënyrë efektive të sulmeve të tyre, me të cilat ka shumë të ngjarë të përballemi gjatë dhe pas mbylljes për shkak të pandemisë.

Takim me Dhomën e Tregtisë të Diasporës Shqiptare

Në 4 shtator, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Dhomës së Tregtisë të Diasporës Shqiptare. Në këtë takim u prezantuan dhe diskutuan fusha kryesore dhe veprimtaritë e të dyja organizatave, përfshirë mundësitë për bashkëpunim në fushat me interes të përbashkët.

Rreziku i kredisë dhe analiza e rrjedhës së parasë - Raste frymëzuese

AAB, në bashkëpunim me ATTF, ofroi për herë të dytë trajnimin online mbi: “Rreziku i Kredisë dhe Analiza e Rrjedhës së Parave - Raste frymëzuese”, me ekspertin Erik de Jong. Klasat Virtuale u zhvilluan në datat 6-7 dhe 13-14 korrik 2020.

PUBLIKIME

Raporti i CSR 2019 - Bankat për shoqërinë

Për të gjashtin vit radhazi, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) publikoi Raportin Vjetor të Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës (CSR) për industrinë bankare. Publikimi paraqet përpjekjet e bankave anëtare për një shoqëri dhe ekonomi më të mirë, një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.



Raporti Vjetor i AAB 2019

Ky publikim i arritjeve të AAB-së gjatë vitit 2019 tregon veçanërisht se si AAB, përmes veprimtarive të rëndësishme profesionale, përfaqësimit në nivel ekspertësh në çdo takim apo veprimtari, ka rritur më tej praninë e saj shoqërore për publikun e gjerë dhe është kthyer në zërin e përgjegjshëm të bankave, kur bëhet fjalë për marrëdhëniet me institucionet publike vendase dhe institucionet me reputacion ndërkombëtar.



